

RAPORTI
I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit

BSC. në Inxhinieri Elektrike

Universiteti Privat “Albanian University”

Ekspertë të vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Aida Spahiu

Dr. Lindita Dhamo



(Qershor/2018)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc në Inxhinieri Elektrike

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër Nr. 479, datë 10.10.2012
4	Urdhëri i MAS për riorganizimin	Urdhër 52 datë 05.02.2016
5	Vendim i Bordit të Akredimit për Akreditimin e parë	VBA Nr.40 datë 19.05.2017
6	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Inxhinieri Elektrike
7	Cikli i studimit:	Cikli i parë
8	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
9	Kreditet në total (ECTS):	180
10	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
11	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
12	Programi ofrohet nga institucioni	Po
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
17	Nr. i studenteve viti 2017-2018	21

Spal *Reel*

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike

Programi i studimit bachelor në Inxhinieri Elektrike mbështetet nga Departamenti i Inxhinierive, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në Albanian University (AU). Albanian University është një Institucion jopublik i Arsimit të Lartë. Ky institucion është licënsuar në Prill të vitit 2004, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

Programi i studimit bachelor në Inxhinieri Elektrike, filiali i Tiranës, është hapur nga Institucioni në vitin akademik 2013-2014, me të tre vitet e programit të studimit bachelor. Për herë të parë në vitin akademik 2014-2015 janë regjistruar 17 studentë, ndërsa për vitet akademike në vazhdim regjistrimet për herë të parë janë: në vitin akademik 2015-2016, 33 studentë, në vitin akademik 2016-2017, 21 studentë, në vitin akademik 2017-2018, 21 studentë. Në lidhje me diplomimin e studentëve kemi informacion që 6 studentët e parë janë diplomuar në vitin akademik 2014-2015, 18 studentë në vitin akademik 2015-2016 dhe 35 studentë në vitin akademik 2016-2017 dhe 1 student (i mbartur) në vitin 2017-2018. Studentët janë diplomuar me provim formimi dhe vetëm 2 prej tyre, pra 3.33% e studentëve kanë përgatitur temë diplome.

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike zhvillohet në ambjentet e ndërtesës së Albanian University në Rrugën e Kavajës, Tiranë, në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe mbështetet nga Departamenti i Inxhinierive.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akteditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof.Dr. Aida Spahiu dhe Dr. Lindita Dhamo ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku.

Me datë 29.05.2018 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 04.06.2018 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe vendosën ti marrin në konsideratë ato duke i reflektuar në Raport përfundmtar.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti Jopublik “Albanian University”, duhet të ndjekë përmbushjen e rekomandimeve të mëposhtme:

- 1) Të shihet mundësia e realizimit të praktikës mësimore në katër javë, në mënyrë që të jetë në përputhje me numrin e krediteve që ka lënda;
- 2) Të përmirësohet cilësia e studentëve të pranuar në këtë program studimi;
- 3) Të rritet mobiliteti i studentëve si dhe trajnimet profesionale;
- 4) Të rritet bashkëpunimi me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit;
- 5) Të shtohet pjesëmarrja si partnerë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;
- 6) Të shihet mundësia e gjetjes së burimeve të tjera financiare, përveç tarifave të shkollimit, me qëllim kualifikimin e vazhdueshëm të stafit;
- 7) Të realizohet një raport analitik i përfitimeve nga marrëveshje kontraktuale për realizimin e praktikave profesionale.



II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- Rekomandimin 1): Institucioni ka bërë përpjekje për plotësimin e tij pjesërisht, lënda e praktikës mësimore është bërë 3 javë nga 2 javë që ishte më parë, (rekomandimi i BA është 4 javë). Duke patur parasysh se inxhinieri elektrik është profesion i mirfilltë aplikativ, kërkon që programi i studimit, i cili e përgatit atë të ketë një raport më të mirë në favor të zhvillimit të aftësisë praktikë.
- Rekomandimin 2: Institucioni ka bërë përpjekje për përmbushjen e rekomandimit pasi nota mesatare e studentëve të pranuar gjatë viteve akademik 2016-2017 dhe 2017 – 2018 është respektivisht 7.28 dhe 7.03 për këtë program studimi. Për këtë rekomandim ka ndihmuar dhe VKM mbi notën minimale mesatare për tu regjistruar në ciklin e parë të studimeve.
- Rekomandimin 3: Për të përmbushur këtë rekomandim institucioni ka punuar në drejtim të nxitjes së aplikimeve nga ana e personelit akademik dhe studentëve në programe europiane me mobilitet. Si rezultat ka projekt mobiliteti Erasmus+ me Universitetin e Salernos, ku 1 pedagog dhe 3 studentë do të shkojnë për 1 javë në këtë Universitet.
- Rekomandimin 4: Këtë rekomandim Institucioni e ka përmbushur më mirë pasi ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Konkretisht, në fushën e mësimdhënies ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të arsimit të lartë brenda vendit. Këto marrëveshje deri tani kanë qënë të njëanshme, pasi AU ka marrë nga këto institucione personel akademik të ftuar të kualifikuar.
Me Institucionet e Arsimit të lartë jashtë vendit po synohet të krijohet rrjeti i bashkëpunimit në mënyrë që të organizojnë konferenca të përbashkëta dhe të aplikojnë së bashku në projekte europiane. Kjo konkretizohet me marrëveshjet që institucioni ka në fushën e kërkimit shkencor (me rrjetin italian NetCO, me Organizatën Shqiptare për Cilësinë - AOQ, me organizatën zvicerane SWISS EP).
- Rekomandimin 5: Institucioni në këtë drejtim, ndoshta dhe nga koha e shkurtër, e ka patur të vështirë të jetë si partnere në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Rekomandimin 6: Ky rekomandim nuk është përmbushur nga Institucioni pasi vazhdon të ketë si burim të vetëm financiar tarifat e shkollimit të studentëve. Të ardhurat nga veprimtaritë e tjera fitimprurëse janë të papërfillshme.
- Rekomandimin 7: Institucioni e ka përmbushur këtë rekomandim pasi ka hartuar një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale për realizimin e praktikave mësimore. Vërehet se marrëveshje për praktikat mësimore institucioni ka vetëm me 14 subjekte (marrëveshje pa afat, të viteve 2016-2017), nga 67 subjekte në total që studentët e Departamentit të Inxhinierive kanë zhvilluar praktikat mësimore. Vërehet gjithashtu se numri i studentëve që kanë përfituar praktikë mësimore me subjektet që institucioni ka marrëveshje është i ulët, vetëm 3 studentë nga 16 që ka programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike.

Rekomandimi 1: plotësohet kryesisht nga Institucioni

Rekomandimi 2: plotësohet kryesisht nga Institucioni

Rekomandimi 3: plotësohet kryesisht nga Institucioni

Rekomandimi 4: plotësohet nga Institucioni

Rekomandimi 5: plotësohet kryesisht nga Institucioni

Rekomandimi 6: nuk plotësohet nga Institucioni

Rekomandimi 7: plotësohet nga Institucioni

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, i hapur në Tiranë, synon krijimin e një profili të mirë të studentit të diplomuar në ciklin e parë, i cili të jetë i aftë që nëpërmjet procesit të përfitimit të njohurive dhe vlerësimit, të zhvillojë një sërë shprehish dhe kompetencash, si:

- a) aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë në subjekte të ndryshme ku ka sisteme elektrike të fuqisë, të industrisë, të automatikës, etj.;
- b) aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë teknike drejtpërdrejt në industrinë e prodhimit të pajisjeve elektrike apo të projektimit dhe realizimit të tyre;
- c) pas një periudhe ushtrimi të profesionit, të ketë aftësinë për të drejtuar kualifikimin apo edhe përgatitjen e teknikëve dhe kuadrove të ardhshëm në këto fusha.

Ky program studimi trevjeçar u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet dhe për të përfituar kompetenca më specifike gjatë studimeve të specializuara në programet e ciklit të dytë.

Mundësitë e punësimit për të diplomuarit në këtë program studimi paraqiten si më poshtë:

- Në ndërmarrje, korporata dhe laboratorë ku ka aparatura elektrike të sistemeve elektrike të fuqisë, të industrisë, ente tregtare të ndryshme që kanë pajisje elektrike, si në industri, shëndetësi etj;
- Në subjekte të ndryshme private apo shtetërore të pajisura me sisteme elektrike dhe elektronike;
- Në kurse të ndryshme profesionale për përgatitjen e teknikëve elektrik etj.

Procesi mësimor dhe kërkimi shkencor në Albanian University synon rritjen e cilësisë së mësimdhënies në mënyrë që t'u japë studentëve aftësi metodologjike për kërkim si dhe përpiqet të sigurojë integrimin e mësimit me punën kërkimore.

Albanian University bën përpjekje në plotësimin e disiplinave mësimore me njohuri shkencore dhe praktike të avancuara, kualifikimin e personelit akademik, si dhe krijon ambiente laboratorike për zhvillimin dhe punën në institucion, etj.

Albanian University me anë të marrëveshjeve me kompani të ndryshme mundëson realizimin e praktikave profesionale për studentët si dhe kryen veprimtari të tjera në përputhje me statutin e Albanian University, sipas objektivave specifike të institucionit në këtë drejtim.

Në kuadër të zhvillimit të kurrikulave, për programet që mbështet Departamenti i Inxhinierive, bëhen përpjekje për një përditësimi të vazhdueshëm të njohurive të marra në këto programe studimi.

Departamenti parashikon, si strategji afatmesme :

1) hapjen e programeve të reja studimi në përputhje me nevojat e tregut:

- Master Profesional në Sisteme të Energjisë,

- Master Profesional në Inxhinieri Kompjuterike.

2) Kualifikimi i mëtëjshëm i të diplomuarve nëpërmjet kurseve mbi standardet ndërkombëtare dhe europiane për sisteme të ndryshme menaxhimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>K3. Programi i studimit është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, dhe në përputhje me qëllimet dhe misionin e Albanian University.</p> <p>K4. Programi i studimit i ka të përcaktuar qartë objektivat për formimin e studentëve në këtë program, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit</p> <p>K5. Programi i studimit është hartuar në përputhje të plotë me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik, duke patur parasysh që në Shqipëri ka ndërmarrje të vogla dhe të mesme, të cilat kanë nevojë për një student me diplomë bachelor në Inxhinieri Elektrike.</p> <p>K6. Programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike është hartuar mbështetur në strategjinë për zhvillim të institucionit dhe të njësisë kryesore. Me anë të këtij programi studimi institucioni ka për qëllim pajisjen e studentëve me njohuritë bazë duke u bazuar mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme. Në përfundim të kryerjes së programit, studentët formohen me shprehje praktike specifike të profesionit, në realizim të misionit dhe qëllimit të institucionit.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <p>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal,</p>	<p>K1. Programi i studimit bachelor në Inxhinieri Elektrike mbështetur në objektivat strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar synon të plotëso nevojat e tregut të punës.</p> <p>K2. Institucioni ka bërë një vlerësim të nevojave të tregut të punës, për qytetin e Tiranës ku është hapur ky program studimi.</p> <p>Në këtë studim tregu jepet informacion në lidhje</p>

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

<p>kombëtar e ndërkombëtar;</p> <p>b. kërkesat e punëdhënësve;</p> <p>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>me:</p> <p>a. Analizën e tregut të punës bazuar në të dhënat e INSTAT 2016, me fokus të veçantë në fushat inxhinierike</p> <p>b. Pyetsorë të ndryshëm, rezultate dhe analizë e pyetsorëve drejtuar studentëve</p> <p>c. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</p> <p>d. kërkesat e punëdhënësve;</p> <p>e. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program.</p> <p>f. Nuk ka informacion për numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>
<p>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Ky program studimi është në përputhje të plotë me interesat kombëtare dhe synon të ruajë vlerat kulturore e kombëtare.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Programi i studimit bachelor në Inxhinieri Elektrike, i hapur në qytetin e Tiranës, i plotëson më së miri të gjitha kriteret e standarteve I.1, I.2, II.1, II.2: Programi i studimit është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, dhe në përputhje me qëllimet e misionin e Albanian University, janë në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe synojnë ruajtjen e vlerave kulturore e interesave kombëtare.</p> <p>AU bën një informim të mirë të studentëve në lidhje me programin e studimit i cili ndodhet në faqen e Universitetit www.albanianuniversity.al. Ka informacion në lidhje me listën e lëndëve, aktivitetet e karakterit kërkimor shkencor, shërbime në ndihmë të studentit, etj., por informacioni duhet të plotësohet me programet e shkurtuara http://www.albanianuniversity.al/al/programe-studimi.</p> <p>Institucioni ka kryer studim të tregut të punës duke dhënë informacion për kërkesat e punëdhënësve në qytetet kryesore të vendit, nivelin e pagës mesatare sipas grup profesioneve, ka kryer pyetësor tek studentët dhe ka analizuar rezultatet në funksion të njohjes së tregut të punës.</p> <p>Standardet plotësohen nga Institucioni.</p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Mbështetur në RVB dhe organigramën e Albanian University, material në dosjen e akreditimit DA, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është njësi kryesore e

Albanian University që organizon e drejton mësimdhënien dhe kërkimin shkencor dhe ka 3 Departamente: Departamentin e Arkitekturës, Departamentin e Inxhinierive dhe Departamentin e Shkencave Ekonomike.

Fakulteti ofron programe të ndryshme studimi në 2 cikle studimi, që mbështeten nga 3 departamente:

1. Departamenti i Arkitekturës ofron: 1 program studimi Bachelor, 1 program studimi Master i Shkencave, 1 program studimi Doktoraturë
2. Departamenti i Inxhinierive ofron: 5 programe studimi Bachelor, 4 programe studimi Master i Shkencave,
3. Departamenti i Shkencave Ekonomike ofron 2 programe studimi Bachelor, 2 programe studimi Master i Shkencave, 2 programe studimi Master Profesional dhe 1 program studimi Doktoraturë.

Nëse krahasojmë dokumentacionin në Dosjen e Akreditimit me informacionin e marrë në faqen e AU, ka një mospërputhje me numrin e programeve të studimit që zhvillon Departamenti i Shkencave Ekonomike. Në faqen e AU deklarohen 2 programe studimi Master Profesional ndërsa në dokumentat e DA deklarohen 3 programe studimi Master Profesional.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përbëhet nga autoritete drejtuese akademike, organe drejtuese administrative, njësitë bazë, organe kolegjiale dhe nga administrata.

Autoritetete drejtuese akademike janë Drejtuesi i Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë ndërsa organ kolegjial është Dekanati. Asambleja e Personelit Akademik është organ drejtues akademik.

Aparati administrativ i Fakultetit përbëhet nga Sekretaria mësimore dhe nga personeli ndihmës (asistentët e departamenteve, laborantët, asistentet e praktikave mesimore).

Struktura organizative, përbërja, funksionimi dhe të tjera çështje që lidhen me të, përcaktohen në rregulloren e fakultetit.

Në AU, në zbatim të nenit 43 të Ligjit Nr. 80/2015, Dekanati është organ kolegjial që drejtohet nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore dhe përbëhet nga:

- a. Drejtuesi i Njesisë Kryesore;
- b. Zëvendësdekani;
- c. Administratori i njësisë kryesore;
- d. Drejtuesit e njësive bazë.

Dekanati harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore, mbështetur në propozimet e njësive bazë të tij, si dhe ato të Administratorit të njësisë kryesore. Dekanati koordinon veprimtarinë e njësive bazë.

Drejtuesi i Njesisë Kryesore është autoriteti akademik më i lartë drejtues dhe përfaqësues i Fakultetit, në zbatim të Statutit të AU (neni 29). Në AU, Drejtuesi i Njesisë Kryesore propozohet nga Rektori, dhe zgjidhet nga Senati Akademik mbi bazë të një procesi konkurrimi, mbi bazën e kandidaturave alternative. Drejtuesi i Njesisë Kryesore duhet të gëzojë titullin shkencor "Profesor", ose "Prof. Asoc.", ai/ajo zgjidhet për një mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë riemërimi vetëm një herë.

Drejtuesi i njësisë kryesore ka këto detyra:

- a. koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve të njësisë kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre;
- b. përgatit propozimin përkatës për çdo vendimmarrje të njësisë bazë;
- c. përgjigjet para Senatit Akademik për mbarëvajtjen e aktivitetit të tij;
- d. i propozon Komisionit të Përhershëm "Për kurrikulat dhe mësimin" hapjen apo mbylljen e programeve të studimit si dhe reformimin e kurrikulave, të Departamenteve apo njësive të veçanta në Fakultet; Kjo pikë e rregullores është në kundërshtim me ligjin Nr.80/2015 datë 22/07/2015, ku sipas nenit 25 pika 7, propozimin për hapjen e programeve të studimit e bëjnë Drejtuesit e Njësive Bazë.
- e. i propozon Rektorit shkarkimin e autoritetit drejtues të njësisë bazë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të Ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit;
- f. i propozon Administratorit të Përgjithshëm të AU shkarkimin e administratorit të njësisë kryesore.

Drejtuesi i njësisë kryesore mban përgjegjësi direkte lidhur me veprimtaritë si vijon:

- a. Aktivitetin mësimor dhe kërkimor-shkencor të Fakultetit,
- b. Organizimin e eventeve shkencore dhe promovuese,
- c. Administrimin e rregullt të dokumentacionit akademik dhe mësimor,
- d. Zbatimin e programit vjetor të Fakultetit,
- e. Disiplinimin e punës nga ana e personelit akademik dhe joakademik,
- f. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së veprimtarisë së Fakultetit,
- g. Çështje të tjera të Fakultetit të lidhura me procesin e akreditimit.

Drejtuesi i Njësive Kryesore në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me vendime dhe/ose udhëzime.

Zëvendësdekani emërohet dhe shkarkohet nga Rektori, me propozim të Drejtuesit të Njësive Kryesore dhe me pëlqimin e Rektorit, për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë riemërimi. Ai duhet të ketë së paku gradën shkencore "Doktor i Shkencave". Numri i zëvendësdekanëve të një Fakulteti përcaktohet nga Bordi i Administrimit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit


Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përbëhet nga departamentet:

- Departamenti i Inxhinierive
- Departamenti i Arkitekturës
- Departamenti i Shkencave Ekonomike

Departamenti është njësi bazë mësimore-shkencore në Fakultet, sipas përcaktimeve të bëra në Statutin e AU (neni 16). Departamenti ka për detyrë të nxisë, organizojë dhe të administrojë veprimtaritë e mësimdhënies dhe Kërkimit Shkencor duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij. Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me grada dhe tituj. Departamenti organizohet në grupe mësimore e kërkimore.

Drejtuesi i Njesisë bazë në Fakultet, në zbatim të Statutit të AU (neni 30) është autoriteti akademik më i lartë drejtues i njësisë bazë, i cili drejton, organizon, koordinon dhe përgjigjet për punën mësimore dhe kërkimore shkencore në njësinë bazë dhe i raporton Drejtuesit të Njesisë Kryesore. Drejtuesi i Njesisë bazë propozohet nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore mbi bazën e kandidaturave alternative dhe emërohet nga Rektori në bazë të një procesi konkurrimi, për një mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë riemërimi vetëm njëherë.

- Struktura akademike e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara është si në skemën më poshtë, funksioni i çdo hallke u shpjegua më sipër:



- Sipas të dhënave të RVB dhe dokumentacionit përkatës marrë në vizitat në institucion, struktura akademike e fakultetit ka të dhënat si në tabelë:

IAL	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike						
	(Viti akademik 2017 - 2018)						
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Total
Gjithsej	Tituj/Grada	Gjithsej	Tituj/Grada	Gjithsej	Tituj/Grada	PAE&PAK	

Spalun *Rektor*

Departamenti i Arkitekturës	21	(1) Prof. Dr. (1) Prof.Asoc.Dr. (7) Dr. (12) MSc.	19	(4) Prof. Asoc. Dr. (10) Dr. (5) MSc.	17	(7) MSc. (4) MP (5) BSc. (1) Mesem	40
Departamenti i Inxhinierive	23	(2) Prof. Asoc. Dr. (8) Dr. (13) MSc.	14	(1) Prof. Dr. (7) Prof. Asoc. Dr. (5) Dr. (1) MSc.			37
Departamenti i Shkencave Ekonomike	23	(1) Prof. Dr. (4) Prof. Asoc. (8) Dr. (10) MSc.	22	(3) Prof. Dr. (9) Prof. Asoc. (4) Dr. (1) Docent (5) MSc.			45
Gjithsej	67		55		17	TOTAL	139

Në tabelë i kemi vënë bashkë personelin administrativ pasi, anëtarë të ndryshëm të këtij grupi kryejnë punë në departamente të ndryshëm të fakultetit dhe në RVB ishin përfshirë në dy apo tre departamente. Në këtë grup ishin futur dhe drejtuesit e departamentit kur ato janë personel akademik dhe jo personel administrativ.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Personeli akademik përbëhet nga Personel Akademik Efektiv (PAE), Personel Akademik me Kontratë (PAK) si dhe Personel Administrativ (PA).

Raporti i PAE/PAK për vitin akademik 2017 – 2018 është 23/14 (e dhënë për departamentin) dhe 17/10 (e dhënë për programin e studimit). Megjithë përpjekjet e bëra nga institucioni, standarti III.1 Kriteri 2, nuk plotësohet as për departamentin dhe as për programin e studimit, pasi përqindja personelit PAE është më e vogël se 70% e stafit të angazhuar (62.16% për departamentin dhe 62.96% për programin e studimit). PAE mbulon 72.94% të ngarkesës mësimore për këtë program studimi. Cilësia e personelit PAE ka një përmirësim për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike pasi nga personeli PAE, rreth 53% janë me tituj e grada, 1 Prof.Asoc, 8 Doktor nga 17 personel PAE gjithsej). Cilësia e personelit PAE për Departamentin e Inxhinierive është 43.5% e PAE janë me tituj e grada (10/23). Pjesa tjetër e PAE është Msc. ose doktorantë në proces. Personeli PAK është pjesa më e kualifikuar e stafit, 100% me tituj e grada shkencore (për programin e studimit).

Raporti i Personelit akademik/Personelit ndihmës-akademik me karakter mësimor/Personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ/student, për vitin akademik 2017 – 2018 është 37/2/10/491, e dhënë për departamentin, tek personeli akademik janë 23 PAE dhe 14 PAK, numri i studentëve për të gjitha programet e ciklit të parë, 5 Bsc dhe të dytë, 4 Msc. që mbështet departamenti i inxhinierive).

Shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik është bërë si më poshtë:

Titullarët e lëndëve janë së paku me titullin Prof.Asoc.(Në llogaritjet e mëposhtme janë konsideruar 36 lëndë gjithsej nga 38: Praktika mësimore dhe Tema e diplomës nuk janë konsideruar.)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DA, vihet re se shumica e titullarëve të lëndëve është nga personeli PAK, konkretisht :

- o rreth 55.56% e programit mësimor (20 lëndë nga 36 gjithsej) ka titullar lënde personel PAK,
- o rreth 44.44% e programit (16 lëndë nga 36 gjithsej) ka titullar lënde personel PAE dhe
- o ndërkohë që 41.66% e programit mësimor (15 lëndë nga 36 gjithsej) ka si titullar lënde 1 pedagog të vetëm, Prof. Asc. Viktor Topulli, pjesë e PAE.

Ky numër duhet rregulluar pasi nuk mundet që një Prof. Asc. të jetë titullar i 15 lëndëve.

Lektorët janë së paku me gradën Doktor. Lektorët janë 44.44% personel PAK dhe 55.56% personel PAE. Nuk ka lektor me gradën Msc.

Një problematikë tjetër që vihet re dhe që mendojmë se ndikon negativisht në cilësinë e mësimdhënies është tek shpërndarja e ngarkesës: të gjithë lektorët pjesë e PAE kanë detyrimin e zhvillimit të një numri të madh lëndësh, 5-9 lëndë. Konkretisht , nga personeli PAE:

B. C.	zhvillon 9 lëndë,
L. P.; F. B.; G. M.	zhvillojnë nga 8 lëndë seicili,
G. R.	zhvillon 7 lëndë,
B. K.	zhvillon 6 lëndë,
B. T; S. D; K. K.; M. R.	zhvillojnë nga 5 lëndë seicili, etj.

Gjithashtu shumica e PAE japin mësim në 5 – 7 programe studimi.

Mendojmë që kjo krijon vështirësi në fokusimin e lektorëve ose asistent lektorëve në lëndët që zhvillojnë, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përditësimin e njohurive që ata duhet të japin tek studentët.

Rekrutimi i personelit akademik në AU bëhet nëpërmjet një procedure konkurruese dhe transparente. Procedura nis me njoftimin që Drejtuesi i Njesisë Bazë i bën Drejtuesit të Njesisë Kryesore për vendet vakante shoqëruar me kërkesat për Kandidatët. Zyra e Burimeve Njerëzore, bazuar në këto kërkesa shpall njoftimin në faqen e AU, në televizionin e institucionit si dhe bën njoftim edhe në Zyrën e Punës. Sipas afateve të njoftuara pritet

dorëzimi i dokumentacionit të kandidatëve, i cili shqyrtohet nga një komision me përfaqësues nga Departamenti dhe Fakulteti përkatës si dhe nga zyra e burimeve njerëzore. Dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët konkurrentë vlerësohet nga komisioni dhe përzgjidhen më të përshtatshmit. Kandidati i përzgjedhur i nënshtrohet një periudhe prove deri në 3 muaj, në mbarim të së cilës përcaktohet nëse marrëdhënia e punës do të vazhdojë apo do të ndërpritet. Marrëdhënia e punës mes të punësuarit dhe Universitetit rregullohet nga kontrata e punës, mbështetur në Kodin e Punës, dhe në respektim të Legjislacionit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Gjatë vitit akademik 2017 – 2018 me vendim të Senatit Akademik të AU, nisur nga nevojat e departamenteve për personel akademik, procedurat e rekrutimit u hapën edhe para fillimit të semestrit të dytë. Gjatë vitit akademik 2017-2018, kriteri kryesor për rekrutimin e personelit akademik ka qenë grada shkencore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura didaktike programin e studimit

Programi i studimit bachelor në Inxhinieri Elektrike përbëhet nga:

personel akademik prej 27 pedagogë	(PAE 17/ PAK 10)
Personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor	2
Personeli ndihmës-akademik me karakter administrative	10

- Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe Personelit Akademik me Kontratë, titujt/gradat,

Për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike nga personeli PAE 53% janë me tituj e grada (1Prof.Asoc+8 Doctor) ndërsa pjesa tjetër e PAE është Msc. ose doktorantë në proces. Personeli PAK është pjesa më e kualifikuar e stafit, 100% me tituj e grada shkencore.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Plotëso Tabelën, Aneksi 3)

Titulli/grada	Cilësia e Personelit Akademik për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike (Viti akademik 2017 -2018)		
	PAE	PAK	PAE/PAK
Profesorë	0	1	0/1
Profesorë të As.	1	4	1/4
Dr/Phd	8	5	8/5
Asistent lektor në proces Dr.	2	0	2/0
Asistent lektor me Msc.	6	0	6/0
Personeli ndihmës-akademik (mësimor)	2	0	2/0
Personeli ndihmës-akademik (administrative)	10	0	10/0

Nga të dhënat e tabelës vërehet se krahasuar me akreditimin e parë Departamenti i Inxhinierive ka punuar seriozisht në drejtim të rekrutimit të PAE më të kualifikuar. Gjithsesi stafi akademik, cilësisht vazhdon të dominohet nga personeli PAK.

Të dhënat sipas seksit

Titulli/grada	Të dhënat sipas seksit e Personelit Akademik për programin e studimit <i>Bachelor</i> në Inxhinieri Elektrike (Viti akademik 2017 -2018)			
	PAE Femra	PAE Meshkuj mra	PAK Femra	PAK Meshkuj
Profesorë	0	0	0	1
Profesorë të As.	0	1	2	2
Dr/Phd	4	4	1	4
Asistent lektor në proces Dr.	2	0		
Asistent lektor me Msc.	2	4		
Personeli ndihmës-akademik (mësimor)	0	2		
Personeli ndihmës-akademik (administrative)	7	3		

Nga tabela duket që barazia gjinore është përgjithsisht e respektuar.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Stafi akademik për programin e studimit <i>Bachelor</i> në Inxhinieri Elektrike (Viti akademik 2017 - 2018)					
Personeli sipas titujve/gradave	Numri i PAE dhe PA me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë					
Profesorë të As.					1
Dr/Phd	2	4	1		1
Asistent lektor në proces Dr.	2				
Asistent lektor me MSc.	3	1		1	1
Personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor					2
Personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ ¹	9	1			

Nga të dhënat sipas moshës për PAE dhe PA duket se moshja mesatare për personelin me karakter mësimor është e lartë dhe ka shumë personel, rreth 35% e personelit PAE, që kanë mbushur moshën e pensionit. Gjithashtu vihet re se pjesa e PAE me moshë më të madhe mbajnë një ngarkesë mësimore shumë të madhe:

B. Ç.	71 vjeç	9 lëndë
F. B.	66 vjeç	8 lëndë
V. T.	77 vjeç	3 lëndë dhe titullar i 16 lëndëve

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat



Nga vizita në institucion, u vërejt se personeli akademik PAE, PAK dhe PA është i pajisur me kontratë individuale dhe njih detyrat dhe të drejtat e tij. Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe në Kodin e Punës, institucioni ka hartuar dhe pajisur personelin akademik me dy tipe kontratash individuale :

- kontrata e stafit akademik me kohë të plotë për kategoritë: profesor/lektor/asistent- lektor janë me afat të pacaktuar,
 - kontrata e stafit akademik me kohë të pjesshme për kategoritë: profesor dhe lektor janë me afat të pacaktuar, ndërsa për kategorinë asistent-lektor janë me afat të caktuar.
- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Në lidhje me cilësinë e stafit ndihmës/ administrativ në RVB dhe dokumentacionin e DA nuk ka informacion në lidhje me cilësinë e tyre.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>K1. Nga vizita e kryer në zyrën e burimeve njerëzore të Universitetit dhe nga kontaktet me stafin akademik të brendshëm dhe Drejtuesin e Njesisë Bazë të Inxhinierive konstatuam se institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente duke bërë njoftim për vende bosh në faqen e fakultetit, pasi Departamentet sjellin kërkesat e tyre. Më tej ngrihet një komision vlerësimi nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore të Fakultetit dhe Drejtuesi i Njesisë Bazë për të vlerësuar kandidaturat e paraqitura.</p> <p>K2. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë, që mbështet këtë program studimi, për vitin akademik 2017-2018, përbën 62.96% të personelit akademik të angazhuar. Pjesa tjetër është personel PAK dhe është pjesa më e kualifikuar e personelit për këtë program studimi. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë, që mbështet këtë program studimi, për vitin akademik 2017-2018, mbulon 72.94% të ngarkesës mësimore.</p> <p>K3. Institucioni e kryen vlerësimin e personelit me anë të formularëve të vlerësimit që u jepen studentëve në fund të çdo semestri, rezultatet e këtyre formularëve paraqiten në një raport nga</p>

Spal *Reel*

	<p>Drejtuesi i njësisë bazë. Gjatë vizitës në Institucion pyetëm specialisten e zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë si veprohej me tej pasi merrej raporti nga Drejtuesi i njësisë bazë. Kjo procedurë e ndjekur është procedurë transparente e vlerësimit të personelit.</p> <p>K4. Institucioni mban një bazë të dhënash të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë.</p>
Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor, ose titullin akademik “Docent”.</p>	<p>K1. Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, këtë e konstatuam gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore ku pamë në mënyrë rastësore dosjet e katër anëtarëve të stafit akademik, me kohë të plotë e të pjesshme, të cilat ishin të plota: me kontratat semestrale, CV, diplomat e tyre, lejet nga institucioni (për stafin e ftuar) etj.</p> <p>K2. Nga dokumentacioni i depozituar në dosjen e akreditimit (DA), vërehet se Institucioni e disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër të shoqëruar me informacion për gradën ose titullin, detyrën që ka në departament, statusin PAE apo PAK, lëndët që mbulon. Gjithashtu ka të dhëna edhe për personelin ndihmës mësimor-shkencor dhe atë administrativ</p> <p>K3. Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e stafit publikohen në faqen e universitetit dhe televizionin e AU.</p> <p>K4. Institucioni ka angazhuar titullarë lëndësh, që kanë së paku gradën Prof.Asoc, të cilët kanë hartuar kurrikulën e lëndës (bën përjashtim vetëm titullari i Gjuhës Angleze me gradë Doktor). Lektorët janë personel akademik që në të gjitha lëndët kanë së paku gradën “Doktor”, dhe nuk ka lëndë që leksionet jepen nga personel akademik me titull Msc. Tek kategoria lektor, 55.56% janë personel akademik efektiv ndërsa 44.44% janë personel akademik me kontratë. Ajo që vlen për të theksuar është që shumica e titullarëve të lëndëve është nga personeli PAK, konkretisht rreth 55.56% e programit mësimor (20 lëndë nga 36 gjithsej) ka titullar lënde personel PAK dhe rreth 44.44% e programit mësimor (16 lëndë nga 36 gjithsej) ka si titullar lënde personel PAE. Nga personeli PAE, 41.66% e programit ka titullar lënde 1 pedagog të vetëm</p>

(15/36 lëndë).

Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;

Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;

Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).

K1. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ka 12 anëtarë në personelin ndihmës mësimor shkencor e administrativ. Departamenti i Inxhinierive ka 2 punonjës për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore, që është një numër i pamjaftueshëm për numrin 491 studentë në total, që ka Departamenti i Inxhinierive për të gjitha programet e studimit që mbështet. Punonjësit e tjerë janë: 1 biblioteka, 2 asistentë departamenti (IT) dhe 2 sekretarë dhe 3 punonjës shërbimesh.

K2. Institucioni e plotëson pjesërisht kriterin 2, pasi burimet njerëzore të ngazhuara i përmbushin pjesërisht nevojat e programeve të ciklit të parë.

K3. Gjatë vizitës në Institucion na u vunë në dispozicion kontratat e lidhura me disa biznese për kryerjen e praktikës mësimore. Sipas dokumentacionit në DA, numri i studentëve të vitit të tretë është 143 për të gjitha programet e studimit bachelor që mbështet Departamenti i Inxhinierive dhe 38 studentë për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike. Mendojmë që ka personel të mjaftueshëm për mbikëqyrjen e praktikës profesionale.

Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.

K1. Institucioni ka organizuar konferenca e leksione të hapura me pedagogë të huaj për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik, të personelit mësimor-shkencor e të studentëve.

K2. Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara, të cilën e pamë në sekretari.

Konkluzionet: Institucioni ndjek procedura ligjore dhe konkurruese të rekrutimit të stafit, bën vlerësimin transparent të tij nëpërmjet formularëve të vlerësimit.

Institucioni nuk e plotëson Kriterin 2 të standartit III.1 pasi personeli akademik i punësuar me kohë të plotë, që mbështet këtë program studimi, për vitin akademik 2017-2018, përbën më pak se 70% të personelit akademik të angazhuar (62,96%) dhe mbulon 72.94% të ngarkesës mësimore. Personeli akademik efektiv PAE ka kualifikim më të ulët krahasuar me atë PAK. Rreth 47% e PAE ka diplomë Master ndërsa rreth 53% ka tituj e grada. Personeli PAK në këtë program studimi është 100% me tituj e grada.

Institucioni e plotëson pjesërisht Kriterin 4 të standartit III.2. Nga të dhënat në RVB bie në sy mungesa e titullarëve të lëndëve nga stafi PAE, pasi 20 lëndë nga 36 gjithsej në programin mësimor, pra 55.56% e programit ka titullar lëndë staf PAK ndërsa pjesa tjetër, ose 44.46% e programit ka titullar lëndë personel PAE, ku shpërndarja është gjithashtu e paarsyeshme sepse vetëm 1 pedagog nga PAE është titullar lëndë për rreth 41.66% të programit mësimor. Lektorët kryesisht janë personel akademik efektiv: 55.56% PAE dhe rreth 44.44% PAK. Shpërndarjen e ngarkesës nuk është e arsyeshme, pasi personeli PAE me moshë 66-71 vjeç zhvillojnë 8-9 lëndë seicili. Gjithashtu, edhe për pjesën tjetër PAE vërehet një mesatare e lartë e numrit të lëndëve që zhvillojnë, duke ndikuar negativisht në cilësinë e mësimdhënies.

Institucioni disponon bazë të dhënash për personelin e tij PAE dhe PAK .

Institucioni plotëson pjesërisht kriteret e standartit III.3. Burimet njerëzore në këtë Institucion janë të mjaftueshëm për ndjekjen e studentëve në praktikat mësimore, por personeli ndihmës akademik me karakter mësimor është i pamjaftueshëm .

Institucioni plotëson kriterin 1 të standartit III.4 për këtë program studimi, por Institucioni duhet të punojë shumë në këtë drejtim pasi 47% të personelit PAE të angazhuar në këtë program studimi janë me titull Msc, e dhënë e marrë nga zyra e burimeve njerëzore dhe faqja e fakultetit. Kjo e pengon Institucionin në zhvillimin e tij afatmesëm dhe afatgjatë. Institucioni me këtë kualifikim stafi PAE që ka për këtë program studimi e ka të pamundur që të hapë program studimi të nivelit të dytë si Master Profesional ashtu dhe Master i Shkencave.

Standardi plotësohet kryesisht nga Institucioni.

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Në shërbim të programeve të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike është vënë në dispozicion një ndërtesë e rikonstruktuar në të gjitha ambientet e saj, e përshtatshme për universitet, me klasa dhe laboratorë. Klasat janë me hapësirë dhe të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, tryeza pune. Laboratorët janë të pajisura me mjetet dhe aparaturat e nevojshme për kryerjen e punëve laboratorike të nevojshme për këtë program studimi.

Për këtë program studimi ashtu si dhe për programet e tjera të studimit që mbështet Departamenti i Inxhinierive ka në dispozicion sallën e internetit dhe bibliotekën, me orar të përcaktuar. Në fakultet ka ambiente për aktivitete promovuese si dhe nyje hidrosanitare.

Institucioni ka siguruar mjedise për Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Administratorin e fakultetit si dhe zyra për Drejtuesin e Njesisë Bazë të Inxhinierive dhe personelin akademik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Fakultetin që ofron Programin e studimit

Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit ¹	Sasia	Sipërfaqja(m ²)
Salla për leksione	6	411.82
Klasa për seminare	7	311.08
Salla studimi	1	127
Salla për praktikë lëndore/profesionale	2	190.15

Laboratorë për lëndët ²	5	155.32
Laboratorë informatike	2	91.1
Salla për bibliotekë/internet	1	62
Mjedis për fotokopjime, librari etj.	1	8.8
Zyrë informacioni për studentët	1	10
Korridore/holle	12	402.54
Nyje hidrosanitare për studentët	15	79.29
Shërbim teknik	1	57.66
Arkiva	2	46.34
Nyjet vertikale	3	82
Sipërfaqe e lirë (taraca)	1	122.85
Norma m ² /për student	2157.95 m ² /659 studentë = 3.27 m ² /për student	

Të dhënat në tabelë janë sipas RVB, me përjashtim të numrit të studentëve. Në RVB norma m²/student është llogaritur duke konsideruar vetëm studentët e departamentit të Inxhinierive për programet e studimit Bachelor, pa përfshirë studentët e Arkitekturës dhe studentët e Programeve master. Pra numri i studentëve duhet korigjuar dhe llogaritja e normës duhet bërë për: 491+168=659. Kështu që realisht, norma e llogaritur në këtë tabelë është edhe më e ulët se ajo e paraqitur në RVB dhe çdo student i takon 3.27 m²/student. Pra ky kriter nuk plotësohet.

Mjediset për stafin	Sasia	Sipërfaqja (m ²)
Zyrë për Dekanin/zyrë mbledhjesh ⁴	1	21.3
Zyra për sekretarinë mësimore/kryesekretar i fakultetit ⁴	2	56.17
Zyra për departamentet	4	69.36
Zyra për personelin akademik/administrator i fakultetit	4	73.35
Mjedis për stafin e shërbimit	3	9
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	2	6.40
Norma m ² /për person	235.58 m ² /100 staf= 2.36 m ² /për person	

Në tabelën korresponduese në RVB figurojnë edhe ambientet për staf me funksione në rang Universiteti (tabela më poshtë), kështu që është e arsyshme të mos përfshihen në llogaritjen e normës së mjediseve për stafin e fakultetit.

Zyrë për financën ⁴	2	47
Zyrë për NJSBC dhe ZZHK ⁴	1	23.2
Zyrë për Koordinimin dhe Mbështetjen ndaj Studentëve ⁴	1	14.8
Zyrë për IT ⁴	1	20

Të dhënat i referohen RVB për ambientet, të cilat ndodhen në godinën e Rr. së Kavajës. Nuk është përfshirë Laboratori i Kimisë, i cili ndodhet në Godinën e Internacionalit.

Nga vizita në Institucion konstatuam se salla e bibliotekës dhe salla e internetit janë një, nuk ka laboratorë të veçantë për lëndën e elektroteknikës dhe të makinave elektrike, ato zhvillohen në të njëjtin ambient. Po kështu dhe laboratorët e elektronikës analoge dhe dixhitale zhvillohen në të njëjtin ambient, mbështetur në listën e laboreve dhe pajisjeve të vëna në dispozicion nga Institucioni. Këto ndryshime nuk ndikojnë në përmbushjen e standarteve për shkak të numrit të vogël të studentëve që ka në këtë stad ky program studimi. Departamenti i Inxhinierive ka ndërtuar edhe dy laboratorë të rinj informatike me 25 poste pune secili.


Institucioni ka salla për të zhvilluar leksionet dhe seminarët për këtë program studimi, si dhe mjedise për stafin akademik dhe sekretarinë mësimore. Informacionin studentët e merrnin në sekretarinë mësimore.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>K1. Nga vizita e bërë në bibliotekën e fakultetit pamë që ka literaturë në shqip, një pjesë e së cilës është e vjetëruar dhe numri i teksteve në gjuhë të huaj ishte i kufizuar. Lista e titujve shqip është shtuar nga pasurimi, që ka patur biblioteka gjashtë muajt e fundit. Gjithsesi në total biblioteka kishte rreth 100 tituj në rreth 300 kopje.</p> <p>Salla e bibliotekës dhe internetit është e përbashkët.</p> <p>K2. Nga biseda me studentët na rezultoi që ata merrnin edhe leksione të printuara ose variante PDF nga pedagogët. Duhet vazhduar përpjekjet për pasurimin e mëtejshëm të bibliotekës me literaturë më bashkëkohore, edhe pse disa përmirësime ka patur.</p> <p>K3. Gjatë vizitës në bibliotekë pamë që përdorshin tre librari elektronike online në mbështetje të programeve të studimit të Departamentit të Inxhinierive.</p> <p>K4. Nga bisedat e bëra mendojmë që përgjegjësit e këtij programi studimi duhet të bëjnë më shumë përpjekje për pasurimin e vazhdueshëm të literaturës në mbështetje të këtij programi studimi, pasi 100 tituj (300 kopje) konsiderohet një numër relativisht i vogël. Duhet theksuar se megjithë kohën e shkurtër nga akreditimi i parë janë bërë përpjekje në këtë drejtim.</p> <p>K5. Biblioteka kishte të shpallura oraret e</p>

	shërbimit, të cilat janë të mjaftueshme për nevojat e studentëve .
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit tëstudimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>K1. Institucioni e plotëson këtë kriter pasi ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për realizimin e këtij programi studimi.</p> <p>K2. Nga vizita në institucion u vu re se mjediset mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie, të pajisura me mjete didaktike, si bankat dhe tavolinat e duhura, projektor, në përputhje me qëllimet e programit të studimit.</p> <p>K3. Nga shqyrtimi i listës së pajisjeve të laboratorëve konstatohet se laboratorët kanë aparaturat dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e laboratorëve të nevojshëm për këtë program studimi.</p> <p>K4. Institucioni e plotëson më së miri këtë kriter, pasi ka 8 laboratore.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Laboratori i informatikës (2 lab) 2. Laboratori i fizikës 3. Laboratori i kimisë 4. Laboratori i elektroteknikës/ makinave elektrike 5. Laboratori i elektronikës analoge dhe digitale 6. Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronike 7. Laboratori i automatikës dhe mekatronikës <p>K5. Në vizitën e bërë në institucion konstatohet se disponon 2 laboratore informatike me 25 kompjutera në çdo laborator, që kanë të instaluar dhe programe kompjuterike të dedikuara për këtë program studimi.</p> <p>K6. Institucioni nuk ka mjedise për zhvillimin e praktikave profesionale për këtë program studimi por ai ka nënshkruar disa marrëveshje me kompani të ndryshme për realizimin e praktikave mësimore.</p>
<p>Konkluzione të GVJ: Institucioni ka bërë përpjekje për pasurimin e bibliotekës me literaturë bashkëkohore në gjuhë të huaj dhe shqip, si dhe zgjerimin e mjedisit të saj. Megjithatë, numri i titujve është ende i vogël dhe përpjekja për pasurim duhet të vazhdojë.</p> <p>Studentët merrnin leksione kryesisht të printuara nga pedagogët prandaj duhen bërë përpjekje për pajisjen me revista periodike si dhe në qendrën e botimeve që disponon Institucioni mund të jepet përpjesë botimeve për degët inxhinierike.</p> <p>Departamenti ka bërë përpjekje për të përdorur librari elektronike më të përshtatshme për këtë program studimi.</p>	

Spalun 

Institucioni i plotëson kriteret e standartit V.2 pasi ka laboratorët e duhur dhe të pajisur me aparatura bashkëkohore për zhvillimin e laboratorëve në këtë program studimi.

Institucioni nuk ka mundësi të zhvillojë praktika në ambjentet e tij. Për këtë qëllim Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani të ndryshme për zhvillimin e praktikave mësimore. Kohëzgjatja e praktikës mësimore është rritur, nga dy javë në tre javë.

Standardi plotësohet nga Institucioni.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Burimet financiare të universitetit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe aktivitete të tjera tregtare të përmendura RVB. Nuk ka informacion të detajuar në lidhje me shpenzimin e të ardhurave. Në rang universiteti ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare, dhe kontrollin e tyre të përmendura më poshtë tek kriteret.

Institucioni ka një raport financiar, bilanc, për çdo vit buxhetor (për të gjitha vitet e kaluara) të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm. Në bilanc ka të dhëna në total për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative etj. Bazuar mbi kriteret e standardeve shtetërore të cilësisë ky Institucion ia ka dalë me sukses që të mbulojë me kosto financiare të gjitha shërbimet e kërkuara.

Kostot operative vjetore ndryshojnë nga njeri program studimi tek tjetri, për shkak të veçorive që ka secili prej tyre. Kështu në programe të tilla, si: Farmaci, Stomatologji, Arkitekturë, Inxhinieri Elektrike etj. kosto për student është më e lartë, krahasuar me programet e tjera sepse baza materiale e përdorur prej tyre dhe numri i vogël i studentëve në grupet mësimore është detyrues.

Burimet financiare janë kryesisht nga tarifat e shkollimit të studentëve. Nuk ka informacion të detajuar për shpenzimet që institucioni bën për qiranë e objektit dhe shërbime të tjera të lidhura me të (mirëmbajtja, pastrimi, ngrohja, ftohja etj.).

Një pjesë e burimeve nga të ardhurave shpenzohet për pagesën dhe sigurimet e punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me reklamën, shërbimin internet, pajisjet e aparaturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit.

Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT-i) të lëshuar nga QKR. Në këtë mënyrë treguesit për të ardhurat dhe financimet nuk janë të veçuara për çdo program studimi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Bazuar në RVB për të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (**në përqindje**):

- | | |
|------------------------------------|------|
| • Grantet për kërkim | 0% |
| • Konsulencat, shërbimet | 0% |
| • Tarifat për dhe gjatë shkollimit | 100% |

- Sponsorizimet 0%
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) 0%
- Donacionet, aktivitetet sigurorese, fondacione etj 0%
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) 0%

- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Kostoja e programit të studimit /student/vit akademik, llogaritet mbi bazën e shpenzimeve që lidhen me fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, honoraret në mësimdhënie, veprimtaritë shkencore, fondi i ekselencës dhe kosto të tjera të departamentit. Sipas RVB, kostoja për një student në programin e studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektrike është 198000 lekë/vit akademik, e cila përbën 99% të tarifës së shkollimit (200000 lekë/vit akademik) që paguan një student në këtë program studimi.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nga vizita në Institucion na u mundësuan vetëm bilancet të cilat u vendosën më vonë në sistem me kërkesën tonë .

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>K1. Institucioni harton raportin e bilancit të gjithë shoqërisë çdo vit në të cilin parashikohen të dhëna të hollësishme financiare për të ardhurat, mbështetur në dokumentacionin e marrë gjatë vizitës në institucion.</p> <p>K2. Institucioni na vuri në dispozicion raportet e auditit të brendshëm për 3 vitet e fundit (Institucioni bën një audit të përvitshëm nga një ekspert kontabël i miratuar dhe i regjistruar) për situatën financiare, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik. Në raportin e auditit konfirmohen të gjitha detyrimet dhe të ardhurat. Raportet e bilanceve vjetore certifikohen nga audit i licensuar.</p> <p>K3. Nga vizitat e bëra në institucion kemi konstatuar që nuk ka grante të huaja, sponsorizime, shërbime trainuese dhe kontrata shërbimesh të lidhura për të mbështetur këtë program studimi.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton</p>	<p>K1. Institucioni ka raport financiar për çdo vit buxhetor të hartuar dhe certifikuar nga auditues të jashtëm të licensuar. Në raportin financiar ka të dhëna për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative etj. Në vizitat e bëra në Institucion na u vu</p>



<p>raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>në dispozicion ky material.</p> <p>K2. Institucioni ka bilance financiare për tre vitet e fundit akademike.</p> <p>K3. Nuk mund të gjykojmë për këtë kriter pasi nuk kemi informacionin e duhur.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Në RVB është dhënë informacion në lidhje me raportin financiar për vitin e fundit 2017-2018. Për të dhënë një vlerësim më të saktë në lidhje me qëndrueshmërinë financiare të Institucionit për këtë program studimi, u kërkuan gjatë vizitës në institucion raportet financiare për tri vitet e fundit, të cilat na u mundësuan.</p> <p>Nga tabela 8 e RVB (me të dhëna vetëm për vitin 2017-2018), shihet qartë se Institucioni ka të ardhura të vetme ato nga tarifat e shkollimit. Institucioni nuk merr grante të huaja për kërkim, për konsulencë apo shërbime për të tretët, nuk ka sponsorizime për studentët apo për këtë program studimi, nuk kryen shërbime për të tretët, që ndikojnë në kualifikimin e vazhdueshëm të stafit.</p> <p>Institucioni AU standartet II.5 në lidhje me vlerësimin e dokumentimin e gjendjes së tij financiare dhe hartimin e raporteve financiare e plotëson ndërsa standartin VI.1 për koston e programeve të studimit nuk e plotëson, pasi raporti financiar mbahet në rang Universiteti dhe në raportin financiar zyrtar të hartuar nga eksperti i licensuar nuk ka të dhëna në lidhje me kostot e programeve të studimit. Sugjerojmë që raportet financiare të hartohen edhe mbi bazë fakultetesh në mënyrë që kostoja e programeve të studimit të llogaritet saktë dhe me transparencë.</p> <p>Standardi II.5 plotësohet nga Institucioni. Standardi VI.1 nuk plotësohet nga Institucioni.</p> <p>Standardi në tërësi plotësohet kryesisht</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkimore

Albanian University ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), në rang Universiteti, duke nisur nga viti 2009, në fillim me Zyrën e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë, strukturë e cila harton politikën, metodologjinë që do të përdoret, dhe mënyrën e përpunimit dhe publikimit të rezultateve. NJSBC e zhvillon veprimtarinë e saj në kuadër të “Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” në AU. Komisioni për Vlerësimin Institucional është përgjegjës për ngritjen, funksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të Sistemit të Brendshëm të Cilësisë në AU dhe kontrollon veprimtarinë e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, mbi bazën e një raporti periodik 6 mujor nga kjo e fundit (neni 13 Rregullorja AU).

NJSBC i vihen në dispozicion nga sekretaria mësimore të dhëna statistikore, të mbledhura gjatë anketimeve të studentëve, raporteve semestrale të pedagogëve, raporteve semestrale dhe vjetore të departamenteve, si dhe rezultateve të arritura nga studentët. NJSBC është në varësi të drejtpërdrejtë të Rektoratit të Universitetit, dhe ka detyrimin e paraqitjes së një raporti vjetor në të cilin përfshihen informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar si dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrevë të cilësisë. Ky raport i paraqitet Rektorit,

i cili më tej e përfshin atë në rendin e ditës së Senatit Akademik për diskutim. Duke u përqendruar kështu jo vetëm në një kontroll të vazhdueshëm për sigurimin e cilësisë, por duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të këtij sistemi për të arritur rezultate maksimale në misionin e Universitetit, që është mësimdhënia.

Funksionet dhe detyrat e NJSBC, janë të parashikuara shprehimisht në nenin 14 të Rregullores së brendshme të Universitetit. Në mbështetje të Statutit, Rregullores, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, kjo zyrë ushtron funksion mbështetës, këshillimor, bashkërendues, monitorues dhe administrativ me strukturat e tjera akademike dhe administrative të Universitetit, si dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë.

NJSBC është përgjegjëse për proceset e akreditimit, rankimit dhe çdo procedure tjetër të vlerësimit të zhvillimit të aktivitetit akademik të universitetit të cilat kryhen në afatet e përcaktuara në ligj apo akte nënligjore, neni 14, pika 2 Rregullore AU.

NJSBC kryesohet nga Desar Agaj dhe është e shpërndarë deri në nivel Departamenti, ku çdo departament ka grupin e vlerësimit të cilësisë, i cili përbëhet nga 2-3 pedagogë në varësi të madhësisë së Departamentit. NJSBC harton politikat e vetëvlerësimit dhe përcakton dhe kriteret e vlerësimit që do të ndiqen, bën të mundur hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese, të cilat me tej iu shpërndahen Departamenteve dhe pas plotësimit të tyre prej studentëve ose pedagogëve, NJSBC bën përpunimin e të dhënave dhe nxjerr problematikat kryesore, përmirësimet që duhen kryer me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, interveprimet të të gjithë faktorëve përbërës së Universitetit.


Duhet theksuar se NJSBC, ka gjithashtu detyrimin e publikimit të të dhënave të nxjerra nga raportet vjetore. Publikimi i këtyre të dhënave duhet miratuar nga instanca më të larta hierarkike dhe deri tani në faqen e Albanian University si raport është Raporti i Vlerësimit Institucional për vitin 2016-2017 dhe raportet vjetore për vitet akademike 2015-2016 dhe 2016-2017.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - Sa anketime kanë bërë me studentët
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
 - Etj

Nga NJSBC realizoheshin dy pyetësorë në vit për studentët, në lidhje më cilësinë e mësimdhënies, para fillimit të provimeve, në fund të semestrit të parë dhe në fund të semestrit të dytë. Këto anketime kryhen në mënyrë elektronike, për të ruajtur anonimin. Pyetësori është për të gjithë studentët të cilët ndjekin këtë program studimi. Një kopje e pyetësorit të studentëve është në sistemin e ASCAL. Pyetësorin e studentëve nuk e gjetëm online në faqen e Universitetit.

Gjatë vitit akademik 2016 – 2017, në semestrin e parë kanë marrë pjesë në anketim 43.8% e studentëve të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, në semestrin e dytë kanë marrë pjesë në anketime 41.2% e studentëve. Gjatë vitit akademik 2017 – 2018 në



semestrin e parë kanë marrë pjesë në anketim 55.7% e studentëve të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike (të dhënat janë marrë nga RVB).

Gjatë vizitës në institucion na u tha që problematikat kryesore që kanë dalë nga studentët ishin: 1) mësimdhënia nga pedagogët e vjetër, afër moshës së pensionit ose mbas moshës së pensionit, të cilët japin kryesisht leksione; 2) Studentët mendojnë që pedagogët që zhvillojnë seminarët i japin ato në nivel më të mirë se ato të leksioneve; 3) shfrytëzimi i kohës së lirë midis orëve të mësimi pasi për shkak se të gjitha programet e degëve inxhinierike e zhvillojnë mësimin në këtë godinë, ato kanë hapsira të lira midis orëve të mësimi.

Gjithashtu departamenti përgatit dhe pyetësorë vetvlerësimi për personelin akademik, dhe një kopje e këtij tipi pyetësori na u vu në dispozicion pas kërkesës sonë. I rekomandojmë institucionit ti vendose formulare dhe dokumente të ndryshëm që i disponon dhe në dosje.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Në Departamentin e Inxhinierive gjatë takimit me personat përgjegjës të NJSBC na u tha që dy pedagogët e departamentit të inxhinierive Dr. Fatmir Basholli dhe Dr. Lek Pepkolaj janë personat përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë për departamentin. Informacionin mbi përbërjen e grupit e kemi marrë nga RVB. Dokumenti i plotë është i vendosur në sistem pas kërkesës sonë.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti (Plotësoni Tabelën 4, Aneksi 4)

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Përveç pyetësorit dy herë në vit për studentët, NJSBC ka organizuar dhe pyetësor me personelin akademik në lidhje me % e kalueshmërisë në lëndën e tyre, mësimdhënien dhe problematika të tjera që lidhen me procesin mësimor. NJSBC ka organizuar dhe fokus grupe me studentë rastësor një herë në vit për të marrë informacion të drejtpërdrejtë nga studentët në lidhje me problematikat e tyre. Pyetësorët e pedagogëve dhe pyetjet që u drejtoheshin pedagogëve nuk na u vunë në dispozicion.

Rezultate e marra nga analiza e pyetësorëve dhe fokus grupeve vendosen në raportet semestrale dhe vjetore të Departamentit të Inxhinierive dhe Fakultetit, (Raporti i Departamentit për vitin akademik 2016-2017). Problematikat dalin nga raportet e departamentit por nuk vazhdohet më tej.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Në raportet semestrale dhe vjetore të përgatitura nga departamenti i inxhinierive jepet informacion në lidhje me gjendjen e programeve të studimit që mbështet, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, pasurimi i bibliotekës së fakultetit me literaturë të re, rezultatet e arritura të studentëve si kalueshmëria dhe nota mesatare, rezultatet e pyetësorëve të studentëve, për secilin pedagog, marrëveshjet e bashkëpunimit me kompani për realizimin e praktikave mësimore, rezultatet e veprimtarisë kërkimore shkencore, analiza SWOT mbështetur mbi këto të dhëna, si dhe propozohen masat për të përmirësuar punën në të ardhmen.

Për shqetësimin e studentëve në lidhje me shfrytëzimin e kohës së lirë ishin vënë fusha shahu në ambjentet e bibliotekës së fakultetit.

Për problematika lidhur me zhvillimin më tej të praktikave mësimore është reflektuar me rritjen e numrin të krediteve nga 3 ETCS në 4 ETCS për vitin akademik 2017-2018. Ndërsa pjesa e personelit akademik në moshë afër pensionimit vazhdon të jetë e njëjtë.

Nga bisedat e zhvilluara në Institucion, si në takimet me përgjegjësen e Departamentin të Inxhinierive, Dekanin e Fakultetit, përgjegjësen e NJSBC, grupin e vlerësimit të brendshëm, stafin dhe studentët kemi marrë informacion të detajuar në lidhje me sigurimin e cilësisë, problematikat dhe ecurinë e rishikimit të kurrikulës. Në dojen e vetvlerësimit janë dhënë RVB, Rregullore e programit të studimit, syllabuste e plota të lëndëve të programit të studimit. Në dosjen e vetvlerësimit mungojnë raportet e vetvlerësimit të bëra nga Departamenti por këto raporte janë të vendosura në sistem pas vizitës në vend.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<p align="center">II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, 	<p>K1. Institucioni përdor formular vlerësimi të plotësuar nga studentët dhe pedagogët në fund të semestrit për të vlerësuar ecurinë e programit të studimit. Institucioni ngre fokus grupe me studentë rastësor për vlerësimin e mësimëdhënies</p> <p>K2. Informacionin e vlerësimit e kemi parë të përfshirë në raportin e përgatitur nga përgjegjësi i departamentit të Inxhinierive për vitin akademik 2016-2017, raportin e semestrit të parë për vitin akademik 2017-2018, raportin e vetvlerësimit për akreditimin institucional.</p> <p>http://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/</p> <p>K3. Institucioni i ka publikuar rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë në raportin e vetvlerësimit për akreditimin institucional. Në takimin që patëm me përfaqësuesen e sigurimit të brendshëm të cilësisë nuk na u dha një përgjigje e saktë se si vazhdohej procedura mbas marrjes së këtyre vlerësimeve, nëse kishte rezultate që ishin nën nivelin e pritshmërisë së kërkuar.</p> <p>K4. Institucioni përdor metoda të tërthorta si:</p> <ol style="list-style-type: none"> Pyetësor të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Raport semestral i personelit akademik për të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; <p>Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta për kryerjen e vlerësimit</p>

<p>provimet, referatet);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Etj.</p>	<p>a. Vlerësimi me nota/pikë;</p> <p>b. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</p> <p>c. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>d. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p>
--	--

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

K1. Institucioni Albanian University ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA) me Nr. 90, datë 20.10.2017 deri më 19/10/2019

K2. Institucioni përdor NJSBC si dhe raportet e përgatitura nga përgjegjësi i departamentit për të analizuar cilësinë e mësimdhënies për këtë program studimi.

K3. Institucioni nëpërmjet formularit të vlerësimit për studentët, pyetësorëve të vetvlerësimit të pedagogëve dhe fokus grupeve, ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programit të studimit.

K4. Mekanizmat formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit janë të paraqitura në rregulloren e programit të studimit.

K5. NJSBC dhe përgjegjësi i Departamentit në raportin semestral dhe vjetor synojnë vënien në dukje të problematikës dhe ndërgjegjësimin e stafit dhe studentëve mbi cilësinë e programit të studimit.

K6. Strategjia, politikat dhe procedurat për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë janë të publikuara në "Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional në Albania University 2017 - 2022".

<http://albanianuniversity.edu.al/sq/strategjia-e-zhvillimit-institucional/>

Konkluzionet e vlerësimit:

NJSBC dhe përgjegjësi i departamentit përgatisin raporte semestrale, vjetore mbështetur në formularët e vlerësimit për studentët dhe personelin akademik, ku evidentohet problematika e shfaqur në mësimdhënie dhe vështërsitë e hasura në realizimin e një mësimdhënie cilësore. Por kjo duhet të vazhdohej më tej, të mos mbetet vetëm në konstatime. Janë bërë përpjekje dhe përmirësime por duhet vazhduar akoma më tej pasi rezultatet e marra nga analiza e vetvlerësimit të programit të studimit janë një shtysë e rëndësishme në ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe të studentëve në lidhje me rritjen e cilësisë së programit të studimit, në mënyrë që studentët të përthithen sa më shpejt nga tregu i punës.

Standartet plotësohen nga Institucioni

Spalce

Dele

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike ka për qëllim të hedhë bazat shkencore dhe përgatitjen teorike-praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si inxhinier në fushën e sistemeve elektrike të fuqisë, të automatizimit të industrisë si dhe në sektorë të tjerë ku përdoret energjia elektrike.

Kjo përgatitje e përgjithshme gjatë periudhës trevjeçare u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet dhe për të përfituar kompetenca më specifike mbi tema më të profilizuara që mund të trajtohen gjatë studimeve të specializuara. Gjithashtu, programi, ka për qëllim t'i përgatisë studentët si specialistë për të punuar në sektorë të tjerë të ngjashëm inxhinierikë.


Programi i studimit ka për qëllim të krijojë një profil të mirë të studentit të diplomuar, i cili do të jetë i aftë që nëpërmjet procesit të përfitimit të njohurive dhe vlerësimit, të zhvillojë një sërë shprehish dhe kompetencash, si:

- a) aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë në institucione e firma të ndryshme ku ka sisteme elektrike të fuqisë, të industrisë dhe të automatikës, etj.,
- b) aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë drejtpërdrejtë në industrinë e prodhimit të pajisjeve elektrike apo të projektimit dhe realizimit të tyre,
- c) pas një periudhe stazhi në profesion, aftësinë për të drejtuar kualifikimin apo edhe përgatitjen e teknikëve dhe kuadrove të ardhshëm në këto fusha.

1. Lëndë Bazë, kategoria e lëndëve A, plani mësimor ka 44ETCS ose 24.44% të programit të përgjithshëm, sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, rekomandohet 15-20%.
2. Lëndë Karakterizuese, kategoria e lëndëve B, të cilat ndihmojnë për përgatitjen shkencore të specialitetit, janë 83 ETC ose 46.1% të programit të studimit. sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, rekomandohet 50-55%.
3. Lëndë ndërdisiplinore ose integruese, kategoria e lëndëve C, ku bëjnë pjesë nëndisiplina dhe grup lëndësh me zgjedhje janë 25 ETCS ose 13.8 % të programit të studimit, sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, rekomandohet 12%-15%.
4. Lëndë plotësuese, kategoria e lëndëve D, ku bëjnë pjesë gjuhë e huaj, informatikë dhe praktika profesionale plotësojnë 22 ETCS ose 12.2 % të programit të formimit, sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, rekomandohet 10%-15%.
5. Detyrime përmbyllëse, kategoria E, Provimi i diplomës plotëson 6 ETCS ose 3.3 % të strukturës Bachelor, sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, rekomandohet 3%-5%.

Kreditet mund të fitohen, të sigurohen, të akumulohen ose të transferohen, nga studenti. Kreditet e një lënde fitohen, kur vlerësimi në atë lëndë është kalues. Nga brenda Universitetit janë të transferueshme të gjitha kreditet e fituara.

Kreditet e një lënde sigurohen kur studenti ka plotësuar kushtet e frekuentimit leksione dhe ushtrime 75%, ka shlyer detyrimet e laboratorëve dhe detyrave të kursit 100% dhe është vlerësuar kalues në provimit të dhënë të lëndës.



Një vit akademik konsiderohet i kryer kur studenti ka fituar jo më pak se 60 kredite. Për përfundimin e studimeve të Ciklit të Parë studentit i duhet të fitojë minimalisht 180 kredite. Afati maksimal i përfundimit të studimeve të plota është gjashtë vite akademike. Afati maksimal i provimit të diplomës është deri në tre vite nga përfundimi i studimeve të plota.

Kontrolli i dijeve bëhet me kontroll gjatë gjithë kohës së zhvillimit të lëndës dhe jo në fund të lëndës. Kështu pjesmarrja aktive gjatë mësimit 10 pikë në 100, rezultatet e arritura në laborator 10 pikë në 100 gjithsej, detyra apo projekti i kursit 10 pikë në 100 gjithsej, provimi i ndërmjetëm 20 pikë në 100 gjithsej. Kështu studenti hynte në provim me maksimumi 40 pikë dhe 60 pikë ishte maksimumi i pikëve për provimin përfundimtar. Studenti quhet kalues me 41 pikë e sipër.

Studentët të cilët kishin mbyllur të gjitha provimet në përputhje me planin mësimor dhe kishin arritur një mesatare mbi 8 përgatisnin temë diplome. Studentët e tjerë, të cilët kishin arritur mesatare më të ulët jepnin provimin përfundimtar. Nga vizita në Institucion mësuam që studentët kryesisht japin provimin përfundimtar. Për këtë përgatitej një listë me pyetje që u jepet studentëve. Kjo listë me pyetje si dhe lëndët, përqindja që zënë lëndët e ndryshme në këtë provim përfundimtar, duhet të vendoset në faqen e Institucionit. Këtë mendim ua transmetuam dhe personelit akademik të departamentit gjatë takimit të zhvilluar.

Në përfundim të studimeve studentët pajisen me diplomë dhe suplementin e tij. Nga kopja e suplementit të diplomës, i cili është detyrim ligjor, konstatuam se nuk është i plotë dhe nuk jep informacionin e kërkuar për studentët. Në të nuk janë të pasqyruar lëndët e çdo viti akademik sipas planit mësimor, por jepej vetëm informacion i përgjithshëm. I rekomandojmë institucionit të rishikojë dhe përmirësojë modelin e suplementit të diplomës sipas kërkesave të MASR.

Në Rregulloren e Programit të studimit, neni 8 vihet në dukje se numri total i veprimtarive formuese është 22, ku janë parashikuar 20 provime, 1 praktikë dhe 1 provimi përfundimtar/ diploma. Ndërkohë në RVB, nga vizita në Departament dhe nga bisedat me studentët dhe anëtarët e grupit të vlerësimit të brendshëm konstatuam se në fakt numri i veprimtarive formuese është 38, ku janë parashikuar 36 provime, 1 praktikë mësimore dhe 1 provimi përfundimtar/ diploma, tabela 10 në RVB, f. 23 dhe f. 24. dhe tabela në anksin e këtij raporti. Më tej bëhej ponderimi i këtyre veprimtarive formuese për të marrë 22 veprimtari në përputhje me udhëzimin Nr. 15, datë 04/04/2008, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Mbështetur në Ligjin e Arsimit të lartë dhe kërkitimit shkencor 80/2015 si dhe aktet nënligjore të mbështetura në këtë ligj Departamenti i Inxhinierive duhet ta ndryshojë panin mësimor me module në atë të detajuar, pasi sjell vështitësi si për studentët dhe për sekretarinë mësimore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike është liçensuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 479, datë 10/10/2012. Ky program studimi është akredituar nga BA me Vendimin Nr. 40, datë 19.05.2017, për një periudhë gjashtë mujore deri në 18/11/2017, për studentët e regjistruar në vitin akademi 2012-2013.

Programi i studimit Bachelor në inxhinieri Elektrike është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare; Gjatë vitit të parë akademik programi i studimit "Bachelor në



Inxhinieri Elektrike” ka si synimin t’u ofrojë studentëve njohuri të përgjithshme të mbështetura në lëndë të formimit bazë të karakterit shkencor. Gjatë dy viteve të tjera akademike, studenti do të thellojë njohuritë që përkojnë me profilin e diplomës “Bachelor në Inxhinieri Elektrike”. Qëllimi i Programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike është t’u ofrojë studentëve njohuri, të cilat do të jenë të nevojshme për to në mënyrë që të ndjekin dhe programe studimi të ciklit të dytë si dhe t’u përgjigjet kërkesave me të cilat do të përballen studentët gjatë realizimit të tyre profesional. Qëllimi i këtij programi është t’i pajisë studentët me aftësi analitike dhe konceptet e nevojshme për të trajtuar problematikat e ndryshme inxhinierike, duke u pajisur dhe me shprehje të veçanta të lidhura me fushën përkatëse të studimit.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)
 - 1 vit akademik ka _30___javë mësimore në auditor
 - 1 Semestër ka _15___javë mësimore në auditor

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike është marrë nga RVB pasi nuk ishte në dosje dhe në sistem. Plani mësimor u vendos pas kërkesës sonë por pa firmat e autoriteteve përgjegjëse dhe pa vulën e Institucionit.

I rekomandojmë Departamentit ta plotësojë në dosje pasi është një dokument i rëndësishëm.

Viti I Lëndë/ Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Leksione			Seminare			Ushtrime			Laborator			DK/PK			Praktike			Punë e Pavarur	Gjithsej	Provine	
				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur				Orë në auditor
1	I	4	3.0	2.5	23	39.5	0	0	1	15	10	4.5	8	0.5	0	0	0	0	0	0	46	54	100		
2	I	6	4.5	3.5	37	50.5	0	0	2.5	30	32.5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	67	83	150		
3	I	6	4.5	3.5	37	50.5	0	0	2.5	30	32.5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	67	83	150		
4	I	4	3.0	2.5	23	39.5	0	0	1	15	10	4.5	8	0.5	0	0	0	0	0	0	46	54	100		
5	I	5	4.0	2.5	23	39.5	0	0	1.5	23	14.5	1	15	10	0	0	0	0	0	0	61	64	125		
6	I	4	2.5	2	23	2	2	1.5	35	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	38	62	100		
7	II	5	4.0	3	30	4	0	0	1	15	10	1	15	10	0	0	0	0	0	0	60	65	125		
8	II	4	2.5	2	23	2	2	1.5	35	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	38	62	100		
9	II	5	3.5	3	30	4	0	0	2	23	27	0	0	0	0	0	0	0	0	0	53	72	125		
10	II	3	2.5	2	23	2	0	0	1	15	10	0	0	0	0	0	0	0	0	0	38	37	7		
11	II	6	4.5	3	30	4	0	0	1.5	23	14.5	1	15	10	0.5	1	11.5	0	0	0	69	81	150		
12	II	3	2.5	1	8	1	0	0	0	0	0	0	2	30	20	0	0	0	0	0	38	37	7		
13	II	5	4.0	2.5	23	39.5	0	0	1.5	23	14.5	1	15	10	0	0	0	0	0	0	61	64	125		
Totali		60	45	33	333	492	4	30	70	175.5	175.5	7	106	69	0.5	1	11.5	0	0	682	818	1500			

Viti II Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Leksione			Seminare			Ushtrime			Laborator			DK/PK			Praktike			Punë e Pavarur	Gjithsej	Provine	
				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur				Orë në auditor
1	I	5	4.0	2.5	23	39.5			1.5	23	14.5	1	15	10	0	0	0	0	0	0	6	125	14.1		
2	I	3	2.5	2	23	27			1	15	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	75	8.1		
3	I	5	4.0	3	30	45			1	15	1	1	15	10	0	0	0	0	0	0	6	125	9.1		
4	I	5	4.0	3	30	45			1.5	23	14.5	0.5	8	4.5	0	0	0	0	0	0	6	125	10.1		
5	I	5	3.5	3	30	45			1.5	23	14.5	0	0	0	0	1	11.5	0	0	0	5	7	125	11.1	
6	I	5	4.0	3	30	45			1.5	23	14.5	0.5	8	4.5	0	0	0	0	0	0	6	125	12.1		
7	I	4	3.0	2.5	23	39.5			1	15	1	0.5	8	4.5	0	0	0	0	0	0	4	5	100	14.2	
8	II	4	3.0	2.5	23	39.5			1	15	1	0.5	8	4.5	0	0	0	0	0	0	4	5	100	8.2	
9	II	5	3.5	3	30	45			1.5	23	14.5	0	0	0	0	1	11.5	0	0	0	5	7	125	11.2	
10	II	4	3.0	3	30	45			1	15	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4	5	100	9.2	
11	II	5	4.0	3	30	45			1	15	1	1	15	10	0	0	0	0	0	0	6	6	125	13	
12	II	5	4.0	3	30	45			1.5	23	14.5	0.5	8	4.5	0	0	0	0	0	0	6	6	125	10.2	
13	II	5	4.0	3	30	45			1.5	23	14.5	0.5	8	4.5	0	0	0	0	0	0	6	6	125	12.2	
Totali		60	46.5	36.5	362	550.5			16.5	251	161.5	6	93	57	2	2	2	0	0	708	792	1500	7		

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

Lëndët/Mo du	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore																		
				Leksione			Seminare			Ushtrime			Laborator			DK/PK			Praktikë		Orë në auditor	Punë e Pavarur
				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur				
1	I	5	4.5	3	30	45			1	15	10	0.5	8	4.5	0.5	1	11.5			54	7	
2	I	5	3.5	2.5	30	32.5		1.5	23	14.5	0.8	12	8	0.2	1	4				66	5	
3	I	5	4.0	3.5	30	57.5		1	15	10	0.5	8	4.5	0	0	0				53	7	
4	I	6	5.0	3.5	37	50.5		2	30	20	0.5	8	4.5	0	0	0				75	7	
5	I	4	3.5	2	23	27		2	30	20	0	0	0	0	0	0				53	4	
6	I	5	3.5	3	30	45		1.5	23	14.5	0.5	8	4.5	0	0	0				61	6	
7	II ¹	5	5.5	2.5	30	32.5		1.5	23	14.5	0.8	12	8	0.2	1	4				66	5	
8	II ¹	5	4.5	3	30	45		1.5	23	14.5	0.5	8	4.5	0	0	0				61	6	
9	II ¹	5	5.0	3	30	45		1	15	10	0.5	8	4.5	0.5	1	11.5				54	7	
10	II ¹	5	5.0	3	30	45		2	30	20	0	0	0	0	0	0				60	6	
11	II ¹	4	27																	80	2	
12	II	6	44 ²	29	300	425		1	227	148	4.6	72	4	1.4	4					4	80	
Totali		60	442	29	300	425		1	227	148	4.6	72	4	1.4	4					4	80	
																					20	
																					31	
																					150	

¹ Lëndët e semestrit të dytë do të zhvillohen në 12 javë mësimore, praktika mësimore do të zhvillohet në 3 javët e fundit të semestrit të dytë.
² Është shuma e orëve në auditor për lëndët/modulët e vitit të tretë. Në të nuk janë llogaritur orët e praktikës mësimore të përqëndruara gjatë 3 javëve të fundit të semestrit të dytë

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:
 - Për leksionet 8 - 12 orë në auditor dhe 17 - 13 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Seminarët 12 - 16 orë në auditor dhe 13 - 9 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Laboratorët 15 - 16 orë në auditor dhe 10 - 9 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Praktikat lëndore ___ orë në auditor dhe ___ orë punë e pavarur e studentit
 - Për Praktikën Profesionale 20 orë në auditor dhe 5 orë punë e pavarur e studentit
 - Provimi përfundimtar 0 orë në auditor dhe 25 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Plotësoni Tabelën 5, Aneksi 5)

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

(Plotëso Tabelën 6, Aneksi 6)




Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset, për të gjitha lëndët janë në dy kopje në dosjen e dorëzuar nga Institucioni për këtë program studimi dhe janë të vendosura dhe në sistemin e Ascal.

Syllabuset janë të përgatitura me kujdes dhe përmbajnë elementët: Emërtimi i lëndës, Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën, numrin e krediteve, Vitin/semestri kur zhvillohet lënda, titullarin e lëndës, kategorinë e lëndës, përshkrim të shkurtër të lëndës, kompetencat, temat e lëndës në lëksione dhe ushtrime, ngarkesa në auditor dhe jashtë tij, metodologjia e mësimdhënies, detyrimi i studentit për lëndën, format e vlerësimit, literatura bazë dhe ajo shtesë.

Duhet theksuar që personeli akademik ka përmirësuar literaturën, duke shtuar dhe literaturë të viteve të fundit.

Mbështetur në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" syllabuset duhet të përmirësohen më tej duke shtuar dhe elementët: lloji i lëndës, nëse është lëndë me zgjedhje apo e detyrueshme; kodin e lëndës; adresën elektronike të titullarit të lëndë/pedagogut të lëndës; konceptet themelore të lëndës; vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	K1. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektike që ofron Institucioni është i akredituar. Ky program studimi është i organizuar në module përgjatë 6 semestrave dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). K2. Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student që ndjek këtë program studimi me

	kohë të plotë është 60 kredite me numër mesatar lëndësh 12-13 të organizuar në 7-8 module.
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>K1. Nga takimi me studentët konstatoam se ata merrnin informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programit të studimit kryesisht nga sekretaria mësimore. Nëse kishin pyetje apo kërkonin informacion shtesë komunikonin dhe me drejtuesen e departamentit të inxhinierive.</p> <p>K2. Sekretaria mësimore e Fakultetit jepte informacionin e nevojshëm për lëndët e detyruara apo me zgjedhje për semestër.</p> <p>K3. Informacion të plotë studentët merrnin në sekretarinë mësimore.</p> <p>K4. Në faqen e Institucionit për Fakultetin e Inxhinierive jepet vetëm kurrrikula me listën e lëndëve për programin e studimit bachelor në Inxhinieri Elektrike. Do t'i sugjeronim Institucionit që në site të vendosen të paktën lëndët shkurtimisht, me ndarjen në kredite dhe orët përkatëse për leksionet, ushtrimet, laboratorët. Kjo do t'u jepte një informacion më të gjerë studentëve, të cilët dëshirojnë të vinë në këtë program studimi si dhe studentëve që janë regjistruar dhe vazhdojnë këtë program studimi.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Institucioni plotëson Standartin I.1 pasi programi është i organizuar me module dhe i vlerësuar me kredite dhe sasia mesatare e krediteve për një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite.</p> <p>Institucioni duhet të përmirësojë më tej informimin për këtë program studimi. Informim, i cili nuk duhet realizuar vetëm nëpërmjet sekretarisë mësimore por dhe nëpërmjet informacionit më të detajuar në faqen e Institucionit. Ky informacion do të ndihmonte shumë në orientimin e studentëve dhe në marrjen e informacionit të plotë në lidhje me këtë program studimi.</p> <p>Departamenti i Inxhinierive duhet të informojë studentët në lidhje me përmbajtjen e provimit përfundimtar duke e vendosur këtë informacion në faqen e institucionit. Ky informacion mungonte.</p> <p>Standarti plotësohet kryesisht nga institucioni.</p>	

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkimore

Procesi mësimor është i organizuar në vite akademike. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore, 15 javë mësimore për çdo semestër, dhe 6 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Ka tre sezone provimesh të rregullta Studenti zhvillon deri në 23-25 orë mësimore në auditor/javë. Në 25 orë përcaktuese të një krediti përfshihen, përveç orëve mësimore në auditor, dhe koha për punë të pavarur të studentit.

Koha e fillimit, mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet e festave zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik të miratuar nga Senati, Statuti i Institucionit. Gjatë vitit të parë akademik organizohen tre sesione provimesh. Në vitet e tjera akademike organizohen pesë sesione provimesh të përcaktuara në kalendarin akademik të çdo programi mësimor dhe tre sesione diplomimi. Me vendim të Senatit Fakultetet kanë të drejtë të organizojnë edhe sesione të tjera të kufizuara të provimeve të bartura (riprovime), jashtë kalendarit akademik, para përfundimit të semestrit të parë dhe semestrit të dytë. Në këto provime studentët paraqiten kundrejt pagesës përkatëse.

Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyrat ose projekte kursi, praktika profesionale. Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje. Lëndët e këtij programi studimi janë të gjitha lëndë semestrale. Lëndët zhvillohen sipas orarit mësimor të shpallur, të ndërtuar mbi kritere pedagogjike me qëllim shpërndarjen e ngarkesës mësimore në mënyrë të balancuar. Në lëndët profesionale, sidomos në vitin e tretë, kishte filluar aplikimi i softeve të ndryshëm aplikative.

Nga bisedat me studentë dhe personel akademik konstatoam se metodat kryesore të mësimdhënies ishin nëpërmjet slideve, shkrimit në tabelë, mësimdhënie e kombinuar nëpërmjet diskutimeve pedagog studentë etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Detyre
- Praktikë profesionale

Format e kontrollit të njohurive

Forma e vetme e kontrollit të njohurive në provim ishte me shkrim. Në rregullore janë vendosura forma të ndryshme kontrolli por në vizitën e bërë në Institucion na u tha që forma e vetme ishte provimi me shkrim, nga takimi me studentët

Forma të tjera të kontrollit të njohurive janë pyetja e studentëve gjatë realizimit të laboratoreve, dorëzimit të detyrave të kursit apo aktivizimi i tyre gjatë ushtrimeve.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Studentët merrnin informacion nëpërmjet përfaqësuesit të tyre në mbledhjen e departamentit të inxhinierive. Studentët aktivizoheshin në Konferencat studentore të organizuara nga institucioni, 4 studentë të këtij programi studimi do të merrnin pjesë në Konferencën e IV studentore që pritej të zhvillohej.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

9. Studentët

Pjesa përshkimore

Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr.80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe mbi akte të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë.

Programi i studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektrike i drejtohet studentëve, të cilët kanë notën mesatare mbi 6, të përcaktuar me VKM për vitet akademike 2016-2017, 2017-2018.

Në këto dy vite akademike regjistrimi i studentëve është bërë online nëpërmjet sistemit të MASR, më parë bëhej aplikim me dosje.

Mbështetur në RVB, renditja e kandidatëve fitues për këtë program studimi behet duke përdorur formulën e renditjes sipas pikëve të fituara ku: mesatarja sipas VKM zë 70%, mesatarja e gruplëndëve matematikë, informatikë dhe fizikë 30%.


Nga vizita e bërë në sekretarinë mësimore të fakultetit dhe shqyrtimi i dokumentave në mënyrë rastësore për studentët, dokumentat e pranimit të studentëve ishin:

- Diplomë e maturës shtetërore së bashku me çertifikatën e notave.
- Dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011).
- Fotokopje e kartës së identitetit, letër njoftimit ose pasaportës.
- Dy fotografi
- Formulari i aplikimit, ku ka informacion të plotë mbi studentin, emër, atësi, mbiemër; mesatare e shkollës së mesme, nota mesatare e gjuhës së huaj etj.
- Kontrata me Institucionin në lidhje me tarifën e shkollimit
- Fatura e pagesës së bërë për tu regjistruar.

Gjithashtu për studentët që ishin transferuar nga Universitete të tjera si UPT, ishte dhe formulari i ç'regjistrimit.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar, gjatë vizitës në Institucion sekretaria mësimore kishte informacion të plotë në lidhje me numrin e studentëve në hyrje dhe në dalje, kohëzgjatja mesatare e studimeve është 3 vite.

Institucioni ka krijuar duke filluar nga viti 2010, zyrën e karrierës ndërsa me vendim të Bordit të Administrimit të AU është krijuar dhe zyra e mbështetjes së studentëve. Në takimin e zhvilluar në Institucion na u tha që ka dy zyra të ndara për studentët po në takimin me



studentët, ato nuk kishin informacion në lidhje me zyrën e mbështetjes studentore. Ndërsa në materialet e vendosura në faqen zyrtare të AU cilësohet si Zyra e karrierës, koordinimit dhe mbështetjes së studentëve dhe herë Zyra e karrierës dhe alumni. Kjo zyrë ka për qëllim lehtësimin e lidhjes ndërmjet karrierës akademike dhe mundësive të punësimit të studentëve të diplomuar në “Albanian University” dhe promovimin e tyre në kompanitë, organizatat si dhe shoqatat e ndryshme të interesuara për punëmarrës. Kjo zyrë ka prodhuar disa broshura në ndihmë të studentëve si “Udhëzues për zhvillimin e karrierës”, “Manuali i studentëve”, “Manuali për punimin e temës së diplomës” material, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të AU.

Zyra e karrierës organizonte veprimtari mbështetëse si leksione të hapura që nuk përfshihen në kurrikulën e programit të studimit si me OJQ studentore ESTEC, “Patentimi i ideve sipërmarrëse për të rinjtë”, me profesionistë që kanë vite në profesionin e tyre, Konferencën e IV studentore, 11 Maj 2018, ku do të merrnin pjesë 4 studentë nga programi i studimit bachelor në Inxhinieri Elektrike

Nga vizita e bërë në Institucion vumë re që nuk kryhej asnjë aktivitet nga zyra e karrierës, siç mund të jenë ditët e karrierës për nxënësit e shkollave të mesme, për të promovuar këtë program studimi në mënyrë që të rritet cilësia e studentëve në hyrje. Kjo është shumë e nevojshme për këtë program studimi, pasi cilësia në hyrje për këtë program studimi megjithëse ka ardhur në rritje duhet të jetë më e lartë.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr.80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe mbi akte të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë.

Në vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018, regjistrimi i studentëve është bërë online nëpërmjet sistemit të MASR, më parë bëhej aplikim me dosje.

Mbështetur në RVB, renditja e kandidatëve fitues për këtë program studimi bëhet duke përdorur formulën e renditjes sipas pikëve të fituara ku: mesarja sipas VKM zë 70%, mesatarja e gruplëndëve matematikë, informatikë dhe fizikë 30%.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Vëmë re se ka një rritje të cilësisë së studentëve në hyrje dhe si rezultat i vendosjes së notës mesatare 6, me VKM, për të gjithë studentët që duan të vazhdojnë ciklin e parë të studimeve Bachelor në Republikën e Shqipërisë.

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Sipas Viteve	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)	Nota mesat -are ne hyrje	Studentë të transferuar sipas viteve (b)			Studente te transferuar per Brezat (b)	Totali: (a)+(b)	Nota mesat -are ne dalje
			Viti I	Viti II	Viti III			
2011-2012								
2012-2013	0	5.86			13	13	13	
2013-2014	0	5.6		16	2	18	18	
2014-2015	17	6.78	1	3	23	27	44	
2015-2016	33	6.56	1	4	7	12	45	5.82
2016-2017	21	7.28	2			2	23	6.03
2017-2018	21	7.03	7	0	7	14	35	

- Transferimet e mëdha gjatë vitit akademik 2014-2015 janë për shkak të mbylljes së degës së AU në qytetin e Fierit dhe Beratit.
- Ka një mospërputhje të numrin të të transferuarve për vitin akademik 2015-2016 nga te dy dokumentet e vendosur nga AU në sistem, të cilat u kërkuar nga vizita në Institucion. Në tabelë shifrat janë marrë nga file “Shifrat e studentëve në Bsc Inxhinieri Elektrike”, pasi në tabelën tjetër mendojmë se janë shtuar dhe numri i studentëve që janë në stazh.
- Në tabelën e mësipërme notat mesatare i kemi venë mbështetur në dokumentin e sekretarisë vënë në sistem.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Gjatë vitit 2016-2017 janë diplomuar gjithsej 36 studentë. Në RVB ky numër është 36 studentë, f. 32. Mbështetur në raportin vjetor të departamentit për vitin akademik 2016-2017, numri i studentëve të diplomuar pa vite përsëritje është maksimumi 12 studentë.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Nuk ka mobilitet të studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend. Ka vetëm transferime të studentëve nga Universiteti Politeknik i Tiranës në AU.

Të dhëna për punësimin e studentëve

6 studentë janë të punësuar nga 36 studentët e diplomuar në vitin akademik 2016-2017, pra 16.66%, marrë nga RVB.

Numri total të diplomuarve

Gjatë vitit akademik 2014-2015 janë diplomuar 6 studentë,
Gjatë vitit akademik 2015-2016 janë diplomuar 18 studentë,
Gjatë vitit akademik 2016-2017 janë diplomuar 35 studentë dhe 1 student (i mbartur)

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

2 studentë janë punësuar në përputhje me fushën e studimit

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

4 studentë janë punësuar jo në përputhje me fushën e studimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>K1. Pranimi në këtë program studimi bëhet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 dhe aktet nënligjore.</p> <p>K2. Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Mbështetur në RVB duke përdorur formulën e renditjes sipas pikëve të fituara ku: mesarja sipas VKM zë 70%, mesatarja e gruplëndëve matematikë, informatikë dhe fizikë 30%.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>K1. Studentët informohen nga sekretaria mësimore për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p>K2. Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit me anë të plotësimit të formularit të vlerësimit. Rezultatet e vlerësimit të studentëve reklektohen në raportin vjetor të Departamentit të Inxhinierive, raporti për vitin akademik 2016-2017.</p> <p>K3. Zyra e karrierës u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Kjo zyrë organizonte ditë të hapur për studentët në lidhje me përgatitjen e CV, mënyrën e paraqitjes së aplikimeve për</p>

	<p>punë etj. Institucioni në ndihmë të studentëve, duke filluar nga viti 2016 ka ngritur dhe zyrën e mbështetjes së studentëve, e cila ishte në fillet e punës së saj.</p> <p>K4. Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi si dhe trajnohen nga zyra e këshillimit të karrierës në lidhje me përgatitjen e CV.</p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	
	<p>K1. Institucioni disponon statistika për këtë program studimi. Nga dokumentacioni i depozituar në DA dhe i marrë gjatë vizitës në IAL, u pajisëm me informacion mbi numrin e studentëve të diplomuar për këtë program studimi në vite.</p>
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>K2. Nga vizita e bërë në sekretarinë mësimore konstatuam se Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit.</p> <p>K3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim. Këto të dhëna i dispononte sekretaria mësimore e Fakultetit dhe janë të reflektuara dhe në raportin vjetor të departamentit të inxhinierive që mbështet këtë program studimi.</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>K1. Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve nëpërmjet zyrës së karrierës, për këtë duhej që studentët të shkonin të interesoheshin. Zyra e karrierës, orientimit dhe mbështetjes së studentëve përbëhej nga dy persona. Departamenti i Inxhinierive ndjek progresin e studentëve dhe kjo reflektohet në raportin semestral dhe vjetor të departamentit.</p> <p>K2. Orientimi për praktikën mësimore në këtë program studimi realizohej nga departamenti i Inxhinierive dhe jo nga zyra e karrierës. Procesi i zhvillimit të praktikave mësimore ka bërë progres në</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

Institucioni plotëson kriterin 1 të standartit IV.1 por duhet të bëj përpjekje për të rritur cilësinë e studentëve në hyrje duke vënë kritere të tjera përzgjedhëse, pasi nota mesatare e tyre është e ulët për një program studimi të tillë. Kjo reflektohet qartë në kalueshmërinë e tyre dhe rezultatet e arritura për semestrin e parë të vitit akademik 2015-2016.

Institucioni informon studentët në lidhje me mundësitë e punësimit nëpërmejt zyrës së karrierës dhe disponon statistika në lidhje me studentët që ndjekin këtë program studimi.

AU ka krijuar zyrën për koordinimin dhe mbështetjen e studentëve, e cila do ti ndihmojë më shumë studentët në përballjen e tyre për tu punësuar si dhe në inkurajimin dhe zhvillimin e karrierës së tyre në fusha të caktuara studimi.

Institucioni ka bërë përpjekje për të siguruar instucionalizim të praktikave mësimore.

I rekomandojmë Institucionit të jetë aktiv dhe në zhvillimin e ditëve të karrierës për nxënësit e shkollave të mesme për të rritur cilësinë e studentëve në hyrje. Aktivitet ky që nuk kryhej nga zyra e karrierës në këtë Institucion.

Standardi plotësohet kryesisht nga Institucioni

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Institucioni për të mbështetur botimet akademike dhe kërkimin shkencor ka krijuar Zyrën e Koordinimit të Kërkimit-Shkencor dhe Botimeve Akademike, njësinë e botimeve akademike dhe revistën shkencore "OPTIME". AU ka zyrën e Koordinimit dhe kërkimit shkencor. Duke filluar nga viti 2016, mbas hyrjes në fuqi të Ligjit 80/2015 është ngritur dhe zyra e Projekteve dhe Zhvillimit Shkencor si njësi përbërëse e Zyrës së Koordinimit të Kërkimit-Shkencor dhe Botimeve Akademike. Kjo zyrë ka si qëllim kryesor koordinimin e punës kërkimore shkencore në rang institucioni, të bëjnë analizën e realizimit të punës kërkimore shkencore, të përgatisin raportin e punës kërkimore shkencore në rang institucioni, i cili miratohet më tej nga Senati Akademik. Mbetej vetëm në konstatime në lidhje me realizimin e punës shkencore nga departamentet pa marrë masa të mëtejshme për departamentet apo personelin akademik që kishte realizim në nivele të ulëta të punës shkencore.

Zyra e projekteve kishte si drejtim kryesor të punës së saj financimin e ideve, pjesmarrjen në projekte të ndryshme të lançuara nga Komuniteti Evropian si H2020, Erasmus+, IPA, INTERREG, Fondi i Ballkanit Perëndimor etj., si dhe krijimi i rrjetit me universitete brenda dhe jashtë vendit. AU ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi me Universitet brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu kjo zyrë realizon komunikimin me Departamentet për trajnime të ndryshme që zhvillohen në rang instucional. Zyra e projekteve ka një barrë të madhe në realizimin e objektivave të vëna pasi ka në përbërjen e saj vetëm një staf, kur dihet që përfshirja në projekte dhe realizimi i tyre kërkon më shumë staf.

Institucioni ka strategji të zhvillimit institucional në drejtim të kërkimit shkencore pasqyruar në “Strategjinë e zhvillimit Institucional” dhe vendosur në faqen e institucionit.

Departamenti i Inxhinierive ka si një nga objektivat e tij afatmesme dhe afatgjata forcimin e kërkimit shkencor dhe aplikimet në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Departamenti i Inxhinierive ka fituar një Erasmus+ me Universitetin e Salernos, nga e cila kanë përfituar mobilitet 1 pedagog dhe 3 studentë. Është nënshkruar një marrëveshje me rrjetin italian NetCO, me të cilin janë programuar një sërë aktivitetesh akademike dhe kërkimore shkencore. Veprimtaria e parë në kuadër të kësaj marrëveshjeje pritet të jetë organizimi i Javës Europiane të Energjisë së Qëndrueshme – EUSEW 2018. Organizatën Shqiptare për Cilësinë - AOQ, në bashkëpunim me Departamentin e Inxhinierive do të organizoj në datat 21-22 Shtator Konferencën e 14të Ndërkombëtare “Standardization, Prototypes and Quality: A Means of Balkan Countries’ Collaboration”. Institucioni bashkëpunon me organizatën zvicerane Swiss EP dhe po punon në drejtim të ngritjes së një inkubatori të teknologjisë, për t’i dhënë mundësinë studentëve të talentuar për të realizuar idetë e tyre në realizimin e produkteve teknologjike.

Anëtarët e Departamentit të Inxhinierive kanë marrë pjesë në Konferencën e IV Ndërkombëtare “Problems and Challenges of Transformation of the Society towards Standards of the European Union Conference” organizuar nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në bashkëpunim me Kolegjin Universitar Qirjazi, Universitetin Bujqësor dhe Universiteti La Sapienza, Romë, 22 Dhjetor 2017, 9 personel akademik dhe 1 student.

Në vizitën e bërë në Institucion nga takime të ndryshme na u dha i gjithë informacioni si mësipër. Ky infomacion ishte i njëjtë me atë të vënë në RVB.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor

AU ka bërë përpjekje për të rritur nivelin e punës shkencore si nëpërmjet organizimit të leksioneve të hapura si: Leksion i hapur me ekspertin e Swiss EP Tim Ellis, mbi zhvillimin e ideve të reja përmes incubators/accelerators, Leksion i hapur me ekspertin e Swiss EP Aimee Holland, mbi “Marketingu dixhital”, Leksion i hapur EESTEC Tirana me temë “Open Hardware”, Leksion i hapur mbi “Telekomunikacionin me fibra optike” në bashkëpunim me Akademinë Ushtarake “Tomson”;

Trainim informues mbi Erasmus+ nga zyra e Erasmus+, Konferenca e 4-t ndërkombëtare “Problemet dhe sfidat e transformimit të shoqërisë shqiptare drejt standarteve të BE-së” - Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës,

Kolegji Qirjazi, Universitetin La Sapienza të Romës etj, Konferenca mbi standartet, revista “Optime” etj.

- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Në referim të dokumentit të vënë në sistem, numri i botimeve të personelit akademik efektiv të Departamentit të Inxhinierisë është 18, kryesisht në Konferenca, për vitin akademik 2017, dhe 2018. Ky numër nuk është i njëjtë me RVB pasi në të është marrë dhe PAK. Nuk ka informacion për numrin e botimeve si IAL. Nuk ka informacion mbi botimet e personelit akademik të departamentit të inxhinierive në vite.

Numri i projekteve kërkimore të fituara

Një projekt mobiliteti Erasmus+ me Universitetin e Salernos

Numri i projekteve të zbatuara

Nuk ka projekte kërkimore të zbatuara

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

Konferenca të organizuar nga Institucioni janë dy dhe një konferencë është në organizim e sipër

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL

9 personel akademik i Departamentit të Inxhinierive dhe një student,

Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

Tre konferenca studentore të organizuara nga IAL dhe konferenca e IV studentore në organizim për vitin 2018.

Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

Mbështetur në RVB numri i studentëve të Departamentit të Inxhinierisë të përfshirë në kërkimin shkencor është 12 studentë, ku 9 studentë do të jenë pjesëmarrës në Konferencën e IV studentore, në shtator të 2018. Një nga studentët e Departamentit të Inxhinierive është fitues i çmimit të emisionit "Do You have an idea" organizuar nga televizioni Vision+ me sipërmarrës të ndryshëm të vendit tonë.

Numri i Çmimeve Kombëtare

Nuk ka

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion



11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Departamenti i Inxhinierive në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike të AU bën përpjekje për zgjerimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar e ndërkombëtar. Këtë bashkëpunim e ka të materializuar përmes marrëveshjeve në fushën e:

- **mësimdhënies**, me institucione të tjera të arsimit të lartë. Institucioni ka marrëveshje institucionale me universitete dhe kolegje brenda vendit: Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Universiteti Bujqësor i Tiranës, nga të cilët Departamenti i Inxhinierive ka marrë personelin akademik të ftuar në kuadër të mësimdhënies cilësore.
- **kryerjes së praktikave mësimore**, me komunitetin e biznesit dhe tregun e punës. Departamenti i Inxhinierive bashkëpunon me shumë biznese në kuadër të praktikave mësimore. Sipas dokumentacionit në dosjen e Akreditimit (Raport Analitik i marrëveshjeve për praktikat mësimore v.a 2016-2017), ky departament bashkëpunon me 67 subjekte të ndryshme ku zhvillojnë praktikat mësimore të gjithë studentët e programeve të studimit që mbështet ky departament, por vihet re se marrëveshje ka me një numër të vogël të tyre, vetëm 14 subjekte, pra vetëm me 21% të tyre marrëdhëniet janë të institucionalizuara. Pjesa më e madhe e studentëve vectorientohet në tregun e punës dhe nuk e merr orientimin nga departamenti, gjithsesi mbështetjen për vazhdimësinë e procesit mësimor të kësaj etape e ka.
- **mobilitetit të pedagogëve e studentëve** me universitete europiane. Departamenti i Inxhinierive ka një marrëveshje shkëmbimi të stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus+ 2017 me Universitetin e Salernos. Nga ky program përfitojnë mobilitet 1 pedagog dhe 3 studentë të departamentit.
- **si dhe në fushën e programeve kombëtare e ndërkombëtare**. Departamenti i Inxhinierive bashkëpunon me kompaninë italiane NetCO me të cilën parashikonorganizimin në qershor 2018 të Javës Europiane të Energjisë së Qëndrueshme – EUSEW 2018. Gjithashtu Departamenti ka marrëveshje bashkëpunime me organizatën zvicerane Swiss EP me të cilën po punon në drejtim të ngritjes së një inkubatori të teknologjisë, për t'i dhënë mundësinë studentëve të talentuar për të realizuar idetë e tyre në realizimin e produkteve teknologjike, bashkëpunon me Universitetin Bujqësor të Tiranës, me të cilët u organizua Konferenca e IV Ndërkombëtare “*Problems and Challenges of Transformation of the Society towards Standards of the European Union Conference*”, 2017. Në bashkëpunim me Kolegjin Universitar Qirjazi, është parashikuar edhe organizimi i Konferencës së IV Studentore 2018.



Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
- Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare
 - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj
 - Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit
 - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL
 - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
 - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime

Bashkëpunimin kombëtar e ndërkombëtar e analizojmë mbi bazën e treguesve si: numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare, numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj, numri i pjesëmarrësve në trajnime në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit, mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL, infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor, numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime. Të dhënat janë si më poshtë në tabelë.

Aktivitete shkencore individuale dhe në rang Programi studimi në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në vitet e fundit		
1	Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte kombëtare apo ndërkombëtare	1
2	Numri i leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj (ose orë mësimore)	6
3	Numri i pjesëmarrësve në trajnime në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	1
4	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit	3
5	Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	0
6	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/jashtë vendit dhe prezantime	0
7	Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	0

Sipas RVB numri i laboratorëve deklarohet 10, por bëjmë një saktësim që Laboratori I Elektroteknikës dhe i Makinave Elektrike zhvillohet në të njëjtin ambient. Gjithashtu njëri prej laboratorëve të Informatikës shërben edhe si laborator për Infrastrukturën e rrjetave, pra ambiente laboratorike janë 8. Theksojmë se niveli i paisjes së laboratorëve i shërben vetëm mësimdhënies dhe nuk është në nivelin për kërkim shkencor.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:
- Institucionet qeveritare bashkëpunuese
 - Organizatat Profesionale
 - Komuniteti i biznesit, tregu i punës

Departamenti i Inxhinierive ka komunikim dhe bashkëpunim me institucione shtetërore, qeveritare, Organizatat Profesionale e subjekte nga Komuniteti i biznesit dhe tregu i punës, të cilat paraqiten të përmbledhura në tabelën më poshtë.

Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese I	
Organizata:	Lloji i bashkëpunimit
Swiss EP	Në kuadër të ngritjes së një incubator/accelerator
Kompani të huaja:	
NetCO	Evente, projekte, kurse në fushën e energjisë së rinovueshme
Universitete:	
Universiteti Politeknik i Tiranës	Personel akademik I ftuar
Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu"	Shkëmbim stafi
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"	Shkëmbim stafi
Universiteti Bujqësor i Tiranës	Shkëmbim stafi, Evente, projekte
Kolegji "Pjetër Budi"	Projekte, shkëmbim stafi
Universiteti i Salernos	Erasmus +
Kolegji Universitar Qirjazi	Evente, projekte
Komuniteti i biznesit, tregu i punës:	
A. E. Distribution	Praktika mësimore
Computer Copy Center sh.p.k.	Praktika mësimore
Birra Tirana	Praktika mësimore
Xpert Systems sh.p.k.	Praktika mësimore
Engineering Group sh.p.k.	Praktika mësimore
IN2 - Albania	Praktika mësimore
Sinteza CO	Praktika mësimore
Universal Office	Praktika mësimore
Forschner Albania sh.p.k	Praktika mësimore
Xhenlux sh.p.k	Praktika mësimore
Dajti Express sh.p.k.	Praktika mësimore
ITES	Praktika mësimore
Bregu sh.a.	Praktika mësimore
ELAL COM	Praktika mësimore

Sipas Raportit Analitik për marrveshjet e praktikave mesimore v.a 2016-2017, numri i marrveshjeve me subjektet nga komuniteti i biznesit për praktikat mësimore është 14. Bashkëpunimi me organizatat, kompanitë, programet europiane e subjektet nga tregu i punës të renditura më sipër janë të gjitha institucionale, pra ka marrveshje.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;	K1. Institucioni nëpërmjet revistës shkencore "OPTIME" nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet

<p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>shkëmbimit të informacionit si dhe në punën e tyre kërkimore.</p> <p>K2. Institucioni nëpërmjet analizës së punës semestrale të departamentit dhe fakultetit bën vlerësimin e plotësimin të detyrave të vëna.</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>K1. Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit. Si marrëdhënie bashkëpunimi e vendosur, për këtë program studimi, është punësimi i personelit akademik me kontratë PAK, me grada dhe tituj të institucionit publik të arsimit të lartë, nga institucionet e arsimit të lartë brenda vendit. Gjithastu institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit për mobilitet të personelit akademik dhe studentëve</p> <p>Nga dokumentacioni në DA dhe vizita në Institucion, vërehet se janë vendosur disa marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës për këtë program studimi. Institucioni ka filluar të organizojë trajnime profesionale në formën e leksioneve të hapura me pedagogë të huaj në bashkërendim me punëdhënësit. Është hartuar një raport analitik për përfitimet nga marrëveshjet kontraktuale për realizimin e praktikës mësimore. Është e nevojshme që institucionalizimi i marrëveshjeve për praktikat mësimore të rritet.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Universiteti bën përpjekje për nxitjen e bashkëpunimit dhe punës shkencore midis personelit të vet në plotësimin e standartit VII.1</p> <p>Institucioni ka punuar në drejtim të plotësimin të standartit VII.2 pasi ka një marrëveshje bashkëpunimi dhe bën përpjekje për tu përfshirë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare me institucione homologe jashtë vendit. Bashkëpunimi brenda vendit është në nivel të ulët, për programin e studimit bachelor në Inxhinieri Elektrike, pasi është vetëm për marrjen e personelit akademik të ftuar prej tyre.</p> <p>Institucioni ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me kompani të ndryshme për kryerjen e praktikave mësimore për këtë program studimi dhe organizon trainime të mëtejshme profesionale në formën e leksioneve të hapura.</p> <p>Institucioni zotëron një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale për realizimin e praktikës mësimore.</p> <p>Standardi plotësohet kryesisht nga institucioni</p>	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Rekomandimin 1 Institucioni e ka plotësuar pjesërisht.

Rekomandimin 2 dhe 3 i ka plotësuar kryesisht.

Rekomandimi i 4 është plotësuar nga institucioni.

Rekomandimi 5 e ka plotësuar pjesërisht.

Rekomandimi 6 nuk është plotësuar nga Institucioni dhe,

Rekomandimi 7 është plotësuar.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

- Institucioni i Arsimit të lartë Jopublik "Albanian University" ka infrastrukturën dhe laboratorët e duhura për mbështetjen e këtij programi studimi.
- Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike është përgatitur në përputhje me qëllimet dhe misionin e Institucioni i Arsimit të lartë Jopublik Albanian University dhe mbart vlerat kulturore kombëtare.
- Institucioni i Arsimit të lartë Jopublik "Albanian University" mban statistika të plota për studentët, të cilët ndjekin këtë program studimi dhe bën përpjekje për vlerësimin e tyre në vazhdimësi.
- Institucioni i Arsimit të lartë Jopublik "Albanian University" ka shtypshkronjën etij, revistën shkencore "Optime" dhe ka faqen e tij zyrtare ku vendos informacion të plotë.
- Studimi i detajuar për nevojat e tregut për këtë program studimi i ka ndihmuar të kuptojnë nevojat për këtë program studimi.

b. Pika të dobëta:

- 35% e personelit akademik efektiv të angazhuar në këtë program studimi janë në moshë pensioni.
- Personeli akademik me gradën shkencore "Doktor", është i mbingarkuar krahasuar me kolegët e tjerë. Ngarkesa e mësimdhënies nuk është e shpërndarë në mënyrën e duhur.
- Numri i pjesmarrjes së Departamentit të Inxhinierisë, që mbështet këtë program studimi në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare është ende i ulët.

- Mobiliteti i studentëve, të cilët ndjekin këtë program studimi, në Institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit është ende i ulët, vetëm tre studentë.

b. Mundësitë:

- Institucioni i Arsimit të lartë Jopublik "Albanian University" duhet të bëjë më shumë përpjekje për të punësuar personel akademik më të kualifikuar dhe të mbështesë për kualifikim të mëtejshëm stafin akademik që ka.
- Institucioni i Arsimit të lartë Jopublik Albanian University duhet të rrisë numrin e librave shkencore dhe librarive dixhitale të duhura për këtë program studimi si për studentët dhe për personelin akademik.
- Institucioni i Arsimit të lartë Jopublik Albanian University duhet të bëjë më shumë përpjekje për të shpërndarë informacionin në lidhje me këtë program studimi me qëllim që të ketë cilësi më të mirë të studentëve, që dëshirojnë të ndjekin këtë program studimi.
- Rritja e bashkëpunimit midis AU dhe institucioneve homologe të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, jo vetëm për të marrë prej tyre personel akademik të ftuar por për të qenë partner në projektë të ndryshme dhe shkëmbyer staf do të ndihmojë në rritjen e cilësisë së programit të studimit.

c. Pengesat:

- Institucioni i Arsimit të lartë Jopublik "Albanian University" ka vështërsi të kualifikimit të mëtejshëm të personelit akademik efektiv.
- Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike ka një numër të vogël studentësh në hyrje. Numri i ulët i studentëve që ndjekin këtë program studimi krijon vështërsi në arritjen e objektivit afatgjatë që ka departamenti i inxhinierive, hapjen e programit të ciklit të dytë.
- Shpërndarja në mënyrën jo të duhur të ngarkesës mësimore për personelin efektiv dhe mbajtja e leksioneve në masën 36% nga personel akademik i ftuar zvogëlon mundësitë e institucionit për të arritur objektivat afatgjatë në këtë program studimi, hapjen e Masterit Profesional në Inxhinieri Elektrike. Kjo do të sjell uljen e interesit të studentëve cilësor për ndjekjen e këtij programi studimi të ciklit të parë.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. Prof. Dr. Aida Spahiu
2. Dr. Lindita Dharmo

ANEKSI 1

Tabela 1: Personeli Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

Fakulteti i Shkencave të Aplikuarra dhe Ekonomike	Numri i PAE		Numri i PAK		Në Total	
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada
Departamenti i Arkitekturës	21	9	19	14	40	23
Departamenti i Inxhinierive	23	10	14	13	37	23
Departamenti i Shkencave Ekonomike	23	13	22	16	45	29

ANEKSI 2

Tabela 3: Të dhënat e stafit akademik sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre, per programin e studimit

Departamenti i Inxhinierive përgjegjës për programin e studimit <i>Bachelor</i> në Inxhinieri Elektrike						
(Viti akademik 2017 - 2018)						
Personeli Akademik Efekt	Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Viktor Topulli	Pedagog	Prof. Asoc. Dr.	1	Petraç Marango	Prof. Dr. Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Mareglën Bukli	Pedagog	Prof. Asoc. Dr.	2	Adhurim Hoxha	Prof. Asoc. Dr. Universiteti Politeknik i Tiranës
3	Genta Rexha	Përgjegjës departamenti	Dr.	3	Ariana Bejleri	Prof. Asoc. Dr. Universiteti Politeknik i Tiranës
4	Besjana Tosuni	Pedagog	Dr.	4	Enkela Noçka (Karroçi)	Prof. Asoc. Dr. Universiteti Politeknik i Tiranës
5	Lekë Pepkolaj	Pedagog	Dr.	5	Agim Anxhaku	Prof. Asoc. Dr. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
6	Fatmir Basholli	Pedagog	Dr.	6	Igli Tafa	Prof. Asoc. Dr. Universiteti Politeknik i Tiranës
7	Miranda Harizaj	Pedagog	Dr.	7	Indrit Enesi	Prof. Asoc. Dr. Universiteti Politeknik i Tiranës
8	Giorgio Mustafaraj	Pedagog	Dr.	8	Bexhet Kamo	Prof. Asoc. Dr. Universiteti Politeknik i Tiranës

9	Fatmir Brati	Pedagog	Dr.	9	Bledar Kurti	Dr.	Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, AU
10	Klodian Kurti	Pedagog	Dr.	10	Alban Rakipi	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
11	Eglantina Merkaç	Pedagog	Drnt.	11	Luçiana Toti	Dr.	Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu"
12	Armela Mazrreku	Pedagog	Drnt.	12	Romeo Teneqexhi	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
13	Burhan Çanga	Pedagog	MSc.	13	Desar Shahu	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
14	Katerina Dhoska	Pedagog	MSc.	14	Albana Vrapit	MSc.	Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
15	Besmir Kanushi	Pedagog	MSc.				
16	Sidita Çoniku	Pedagog	MSc.				
17	Rodolf Zyka	Pedagog	MSc.				
18	Enis Çerri	Pedagog	MSc.				
19	Malvin Rrushi	Pedagog	MSc.				
20	Robert Kodra	Pedagog	MSc.				
21	Pranvera Hysenaj	Pedagog	MSc.				
22	Arbër Vila ¹	Pedagog	MSc.				
23	Arbër Malaj	Pedagog	MSc.				

Titulli	Stafi akademik i programit të studimit		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	0	1	0/1
Profesorë të As.	1	4	1/4
Dr/Phd	8	5	8/5
Asistent lektor në proces Dr.	2	0	2/0
Asistent lektor me Msc.	6	0	6/0
Personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor	2	0	2/0
Personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ ¹	10	0	10/0

Spolu *Arbër*

ANEKSI 3

Tabela 4: Të dhëna për anëtarët e NJSBC

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë (vite)
1	Dr. Desara Aga	Përgjegjësë NJSBC ne rang Universiteti	2
2	Msc. Sidita Coku	Specialiste, zyra e kurrikulave ne AU	2.5
3	Dr. Lekë Pepkolaj	Anëtar i grupit të sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë	2
4	Dr. Fatmir Basholli	Anëtar i grupit të sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë	2

ANEKSI 4

Tabela 5: Plani mësimor i licensuar

Viti I Lëndë/ Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Leksione			Seminare			Ushtrime			Laborator			DK/PK			Praktikë			Puntë e Pavarur	Gjithsej	Provime
				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur			
1	I	4	3.0	2.5	23	39.5	0	0	15	10	0.5	8	4.5	0	0	0	0	0	0	0	0	46	54	100
2	I	6	4.5	3.5	37	50.5	0	0	2.5	30	32.5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	67	83	150
3	I	6	4.5	3.5	37	50.5	0	0	2.5	30	32.5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	67	83	150
4	I	4	3.0	2.5	23	39.5	0	0	1	15	10	0.5	8	4.5	0	0	0	0	0	0	0	46	54	100
5	I	5	4.0	2.5	23	39.5	0	0	1.5	23	14.5	1	15	10	0	0	0	0	0	0	0	61	64	125
6	I	4	2.5	2	23	2	2	15	35	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	38	62	100
7	II	5	4.0	3	30	4	0	0	1	15	10	1	15	10	0	0	0	0	0	0	0	60	65	125
8	II	4	2.5	2	23	2	2	15	35	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	38	62	100
9	II	5	3.5	3	30	4	0	0	2	23	27	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	53	72	125
10	II	3	2.5	2	23	2	0	0	1	15	10	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	38	37	7
11	II	6	4.5	3	30	4	0	0	1.5	23	14.5	1	15	10	0.5	1	11.5	0	0	0	0	69	81	150
12	II	3	2.5	1	8	1	0	0	0	0	0	2	30	20	0	0	0	0	0	0	0	38	37	7
13	II	5	4.0	2.5	23	39.5	0	0	1.5	23	14.5	1	15	10	0	0	0	0	0	0	0	61	64	125
Totali		60	45	33	333	492	4	30	70	15.5	212	175.5	7	106	69	0.5	1	11.5	0	0	682	818	1500	

Viti II Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Leksione			Seminare			Ushtrime			Laborator			DK/PK			Praktikë			Puntë e Pavarur	Gjithsej	Provime
				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur			
1	I	5	4.0	2.5	23	39.5			1.5	23	14.5	1	15	10	0	0	0	0	0	0	6	125	14.1	
2	I	3	2.5	2	23	27			1	15	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	75	8.1	
3	I	5	4.0	3	30	45			1	15	1	15	10	0	0	0	0	0	0	0	6	125	9.1	
4	I	5	4.0	3	30	45			1.5	23	14.5	0.5	8	4.5	0	0	0	0	0	0	6	125	10.1	
5	I	5	3.5	3	30	45			1.5	23	14.5	0	0	0	0	1	11.5	0	0	0	5	7	125	
6	I	5	4.0	3	30	45			1.5	23	14.5	0.5	8	4.5	0	0	0	0	0	0	6	125	12.1	
7	I	4	3.0	2.5	23	39.5			1	15	1	0.5	8	4.5	0	0	0	0	0	0	4	5	100	
8	II	4	3.0	2.5	23	39.5			1	15	1	0.5	8	4.5	0	0	0	0	0	0	4	5	100	
																					4	5	8.2	

ANEKSI 6

Tabela 6: Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Lënda /Moduli		Pedagogu/ët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Statusi PAE apo PAK
1	Fizika 1	Adhurim Hoxha	Prof. Asoc. Dr.		PAK
		Eglantina Merkaçaj	Drnt.	i Inxhinierisë	PAE
2	Analizë matematike 1	Besjana Tosuni	Dr.	i Inxhinierisë	PAE
3	Algjebër - Gjeometri	Lekë Pepkolaj	Dr.	i Inxhinierisë	PAE
4	Kimi	Enkela Noçka (Karroçi)	Prof. Asoc. Dr.		PAK
		Armela Mazrreku	Drnt.	i Inxhinierisë	PAE
5	Elementë bazë të informatikës	Ariana Bejleri	Prof. Asoc. Dr.		PAK
		Besmir Kanushi	MSc.	i Inxhinierisë	PAE
6	Gjuhë e huaj (Sem.I)	Sonila Daiu	Dr.		PAK
7	Fizika 2	Adhurim Hoxha	Prof. Asoc. Dr.		PAK
		Eglantina Merkaçaj	Drnt.	i Inxhinierisë	PAE
8	Gjuhë e huaj (Sem. II)	Bledar Kurti	Dr.		PAK
9	Analizë matematike 2	Besjana Tosuni	Dr.	i Inxhinierisë	PAE
10	Probabilitet dhe statistikë	Lekë Pepkolaj	Dr.	i Inxhinierisë	PAE
11	Elektroteknika 1	Romeo Teneqexhi	Dr.		PAK
		Katerina Dhoska	MSc.	i Inxhinierisë	PAE
12	Hyrje në eksperimentim laboratorik	Genta Rexha	Dr.	i Inxhinierisë	PAE
13	Teknikë dhe gjuhë programimi	Ariana Bejleri	Prof. Asoc. Dr.	i Inxhinierisë	PAK
		Besmir Kanushi	MSc.	i Inxhinierisë	PAE
14	Matje elektrike dhe elektronike 1	Viktor Topulli	Prof. Asoc. Dr.	i Inxhinierisë	PAE
		Burhan Çanga	MSc.	i Inxhinierisë	PAE
15	Analizë komplekse	Lekë Pepkolaj	Dr.	i Inxhinierisë	PAE
16	Elektroteknika 2	Romeo Teneqexhi	Dr.		PAK

		Katerina Dhoska	MSc.	Inxhinierisë	PAE
25	Makina elektrike 2	Fatmir Brati	Dr	i Inxhinierisë	PAE
		Burhan Çanga	MSc.	i Inxhinierisë	PAE
26	Elektronika e fuqisë	Desar Shahu	Dr.		PAK
		Malvin Rrushi	MSc.	i Inxhinierisë	PAE
27	Prodhimi, shpërndarja dhe përdorimi i energjisë elektrike 1	Fatmir Brati	Dr.	i Inxhinierisë	PAE
28	Bazat e automatikës 1	Petraç Marango	Prof. Dr.		PAK
29	Teknikë sigurimi	Fatmir Brati	Dr.	i Inxhinierisë	PAE
		Pranvera Hysenaj	MSc.	i Inxhinierisë	PAE
30	Arkitektura e sistemeve të kontrollit	Alban Rakipi	Dr.	i Inxhinierisë	PAE
		Malvin Rrushi	Dr.	i Inxhinierisë	PAK
31	Ekonomia e ndërmarrjeve elektrike	Dorina Guraj	Dr.		PAK
32	Sistemet elektrike të fuqisë (L.Z. - Gr. 2)	Fatmir Brati	Dr.	i Inxhinierisë	PAE
33	Bazat e automatikës 2	Petraç Marango	Prof. Dr.		PAK
		Burhan Çanga	MSc.	i Inxhinierisë	PAE
34	Transmisione elektrike	Fatmir Brati	Dr.	i Inxhinierisë	PAE
		Burhan Çanga	MSc.	i Inxhinierisë	PAE
35	Prodhimi, shpërndarja dhe përdorimi i energjisë elektrike 2	Fatmir Brati	Dr.	i Inxhinierisë	PAE
36	Cilësia, normativa dhe legjislacioni teknik	Giorgio Mustafaraj	Dr.	i Inxhinierisë	PAE

Spelu *Qela*